

FIZIKA 8
UDHËZUES MËSUESI

Për ju mësues!

Udhëzuesi për mësuesin bën pjesë në serinë e botimeve të teksteve të Fizikës 8 të shtëpisë botuese "Longman". Në të trajtohen, në mënyrë analitike, modele funksionale mësimi për programin e Fizikës së klasës së 8. Këto modele synojnë t'u vijë në ndihmë mësuesve dhe janë në përshtatje me kurrikulat dhe me moshën e nxënësve. Në çdo tematikë shfrytëzohen burime të ndryshme dhe mësuesi/ja mund t'i përdorë ato në funksion të rezultateve të të nxënësve sipas temave të ndryshme mësimore. Është synuar që pjesa kryesore e mësimit të zhvillohet në klasë, duke krijuar hapësira pune për nxënës të çdo niveli dhe me një pjesë e vogël është menduar të punohet në shtëpi, zakonisht rubrika "?", me qëllimin e rimarrjes së njohurive dhe të koncepteve thelbësore. Kjo do t'i shërbejë kryesisht qëndrueshmërisë së njohurive kryesore dhe përdorimit praktik të tyre. Nga ana tjetër, ushtrimet janë frymëzuar nga jeta e përditshme, në mënyrë që nxënësit jo vetëm t'i përvetësojnë njohuritë në mënyrë aktive, por edhe të orientohen drejt dhe të jenë të suksesshëm në situata të ndryshme që u ofron jeta. Gjithashtu, kemi paraqitur tema për orët e lira apo ato që ne i quajmë *projekte*, të cilat janë të thjeshta, lehtësisht të zbatueshme dhe të orientuara drejt jetës reale.

Duke ditur se çfarë ndodh në klasë dhe duke jetuar me shqetësimet e përditshme profesionale, shpresojmë që me këtë tekst udhëzues t'ju vijmë sadopak në ndihmë në përgatitjen tuaj, duke paraqitur modele me karakter orientues e sugjerues, të cilat mund të pasurohen me informacion të përditësuar. Një burim i frytshëm për këtë është edhe adresa e internetit www.fizik.si, ku nxënësit mund të vëzhgojnë eksperimente të ndryshme që kanë lidhje me temat e këtij teksti.

Ju urojmë suksese në zbatimin e kurrikulës dhe në përmbushjen e standardeve të kërkuara për arritjet e nxënësve!

PËRMBAJTJA

I. PLANIFIKIMI VJETOR I PROGRAMIT

II. PLANIFIKIMI TREMUJOR I PROGRAMIT

III. PLANET DITORE TË TEMAVE MËSIMORE

KAPITULLI 1. Forcat dhe lëvizja

1.1. Lëvizja dhe shpejtësia

1. Llogaritja e shpejtësisë, e largësisë dhe e kohës
2. Njësi të tjera të shpejtësisë
3. *Veprimtari praktike*. Sa shpejt lëvizni?
4. Shpejtësia e insekteve
5. Lëvizja njëtrajtësisht e ndryshuar
6. Llogaritja e shpejtësisë mesatare

1.2 Grafikët e lëvizjes

7. Si e ka përshkuar rrugën Albani?
8. Shembuj të grafikëve të varësisë largësi-kohë
9. Grafikët e varësisë shpejtësi-kohë
10. *Veprimtari praktike*. Llogaritja e shpejtësisë dhe e nxitimit
11. Ushtrime
12. Siguria rrugore
13. *Përsëritje*. Lëvizja dhe shpejtësia
14. *Projekt*. Respektimi i rregullave të qarkullimit rrugor
15. *Projekt*. Respektimi i rregullave të qarkullimit rrugor

KAPITULLI 2. Drita dhe tingulli

16. Drita. Burimet e dritës
17. Përhapja e dritës në vijë të drejtë. Hijet
18. Eklipsët
19. *Veprimtari praktike*. Hijet
20. *Veprimtari praktike*. Përhapja e dritës në hapësirë
21. *Veprimtari praktike*. Matja e shpejtësisë së dritës
22. *Përsëritje e njohurive*
23. *Test i tremujorit të parë*
24. *Vlerësim i portofolit të nxënësit*

25. Pasqyrimi i dritës
26. Shëmbëllimi në pasqyrën e rrafshët. Shikimi pas kthesave
27. *Përmbledhje. Përsëritje* për pasqyrimin e dritës
28. Përthyerja e dritës
29. Pasqyrimi i brendshëm i plotë. Zbatimet. Prizmat
30. Thjerrat
31. *Veprimtari praktike*. Përdorimi i thjerrave
32. Funkcionimi i syrit dhe i aparatit fotografik. Kujdesi për sytë
33. *Veprimtari praktike*. Përthyerja e dritës
34. Përsëritje për përthyerjen e dritës
35. Pse na duhen ngjyrat? Ngjyrat e objekteve
36. Filtrat me ngjyra. Ndryshimi i ngjyrave të objekteve
37. *Veprimtari praktike*. Ngjyrat
38. *Detyra*. Thjerrat *Fresnel*
39. *Përsëritje*. Ngjyrat e dritës
40. Prodhimi i tingullit
41. Vala e zërit. Fortësia dhe lartësia e tingullit
42. Dëgjimi i tingullit. Veshi
43. *Përsëritje*. Të dëgjuarit dhe tingulli
44. Jehona. Përdorimi i jhonës
45. Matja e shpejtësisë së tingullit. Ultratingujt
46. *Përsëritje*. Pasqyrimi i tingullit
47. *Detyra*. Jehona
48. *Veprimtari praktike*. Krijimi i melodive muzikore
49. Përdorimi dhe rreziqet që vijnë nga drita dhe tingulli
50. *Përsëritje*. Drita dhe tingulli
51. **Test i tremujorit të dytë**
52. *Vlerësim i portofolit të nxënësit*

KAPITULLI 3. Elektriciteti dhe magnetizmi

53. Drita e padukshme
54. Komunikimi
55. Gatimi. Përdorimi i rrezeve ultravjollcë
56. Përdorimi i rrezeve në mjekësi
57. Vrojtimi i qiellit. Zbatime në astronomi
58. Radioastronomia. Astronomia e rrezeve *X* dhe *gama*
59. *Detyra*. Imazheria mjekësore
60. *Pyetje dhe problema*
61. Si kthehet hekuri në magnet? Çmagnetizimi i magneleve. Fusha magnetike
62. Fusha magnetike e Tokës
63. *Përsëritje*. Magnetizmi
64. Fusha magnetike rreth një përçuesi drejtvizor

65. Ku përdoren elektromagnetet? Releja dhe çelësi magnetik
66. *Veprimtari praktike*. Fusha magnetike e magnetit shufër
67. *Detyra*. Magnetizmi dhe elektromagnetet
68. *Përsëritje*. Elektriciteti dhe magnetizmi
69. **Test i tremujorit të tretë**
70. *Vlerësim i portofolit të nxënësit*

IV. SHTOJCA

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës

Model testi

PLANI VJETOR DHE PLANET TREMUJORE TË FIZIKËS VIII

Plani mësimor vjetor : Klasa VIII
 Fusha: Shkencat e natyrës
 Lënda: Fizikë

Tematikat	Shtator-Dhjetor (24 orë)	Shpërndarja e përbajtjes së lëndës Janar-Mars (28orë)	Prill-Qershor (18 orë)
Kapitulli 1. Forcat dhe lëvizja	Lëvizja dhe shpejtësia 1. Llogaritja e shpejtësisë, e largësisë dhe e kohës 2. Njësi të tjera të shpejtësisë 3. <i>Veprimtari praktike</i> . Sa shpejt lëvizni? 4. Shpejtësia e insekteve 5. Lëvizja njëtrajtësisht e ndryshuar 6. Llogaritja e shpejtësisë mesatare Grafikët e lëvizjes 7. Si e ka përkshuar rrugën Albani? 8. Shembuj të grafikeve të varësisë largësi-kohë 9. Grafikët e varësisë shpejtësi-kohë 10. <i>Veprimtari praktike</i> . Llogaritja e shpejtësisë dhe e nxitimit 11. Ushtrime 12. Siguria rrugore 13. <i>Përsëritje</i> . Lëvizja dhe shpejtësia 14. <i>Projekt</i> . Respektimi i rregullave të qarkullimit rrugor 15. <i>Projekt</i> . Respektimi i rregullave të qarkullimit rrugor		

<p>KAPITULLI 2. Drita dhe tingulli</p>	<p>16. Drita. Burimet e dritës 17. Përhapja e dritës në vijë të drejtë. Hijet 18. Eklipsët 19. <i>Veprimtari praktike.</i> Hijet 20. <i>Veprimtari praktike.</i> Përhapja e dritës në hapësirë 21. <i>Veprimtari praktike.</i> Matja e shpejtësisë së dritës 22. <i>Përsëritje e njohurive</i> 23. Test i tremujorit të parë 24. <i>Vlerësim i portofolit të nxënësit</i></p>		
		<p>25. Pasqyrimi i dritës 26. Shëmbëllimi në pasqyrën e rrafshët. Shikimi pas kthesave 27. <i>Përmbledhje. Përsëritje</i> për pasqyrimin e dritës 28. Përthyerja e dritës 29. Pasqyrimi i brendshëm i plotë. Zbatimet. Prizmat 30. Thjerrat 31. <i>Veprimtari praktike.</i> Përdorimi i thjerrave 32. Funksionimi i syrit dhe i aparatit fotografik. Kujdesi për sytë 33. <i>Veprimtari praktike.</i> Përthyerja e dritës 34. Përsëritje për përthyerjen e dritës 35. Pse na duhen ngjyrat? Ngjyrat e objekteve 36. Filtrat me ngjyra. Ndryshimi i ngjyrave të objekteve 37. <i>Veprimtari praktike.</i> Ngjyrat 38. <i>Detyra.</i> Thjerrat <i>Fresnel</i> 39. <i>Përsëritje.</i> Ngjyrat e dritës 40. Prodhim i tingullit 41. Vala e zërit. Fortësia dhe lartësia e tingullit 42. Dëgjimi i tingullit. Veshi 43. <i>Përsëritje.</i> Të dëgjuarit dhe tingulli 44. Jehona. Përdorimi i jehonës 45. Matja e shpejtësisë së tingullit. Ultratingujt 46. <i>Përsëritje.</i> Pasqyrimi i tingullit 47. <i>Detyra.</i> Jehona 48. <i>Veprimtari praktike.</i> Krijimi i melodive muzikore 49. Përdorimi dhe rreziqet që vijnë nga drita dhe tingulli 50. <i>Përsëritje.</i> Drita dhe tingulli 51. Test i tremujorit të dytë 52. <i>Vlerësim i portofolit të nxënësit</i></p>	

<p>53. Drita e padukshme 54. Komunikimi 55. Gatimi. Përdorimi i rrezeve ultravjollçë 56. Përdorimi i rrezeve në mjekësi 57. Vrojtimi i qiellit. Zbatime në astronomi 58. Radioastronomia 59. Astronomia e rrezeve X dhe gama 60. <i>Pyetje dhe problema</i></p>			
<p>61. Si kthehet hekuri në magnet? Çmagnetizimi i magneleve. Fusha magnetike 62. Fusha magnetike e Tokës 63. <i>Përsëritje</i>. Magnetizmi 64. Fusha magnetike rreth një përçuesi drejtvizor 65. Ku përdoren elektromagnetet? Releja dhe çelësi magnetik 66. <i>Vepërtari praktike</i>. Fusha magnetike e magnetit shufër 67. <i>Detyra</i>. Magnetizmi dhe elektromagnetet 68. <i>Përsëritje</i>. Elektriciteti dhe magnetizmi 69. Test i tremujorit të tretë 70. <i>Vlerësim i portofolit të nxënësit</i></p>			<p>KAPITULLI 3. Elektriciteti dhe magnetizmi</p>

PLANIFIKIMI I TREMUJJORIT TË PARË (SHTATOR-DHJETOR)

Fusha: Shkencat e natyrës
Lënda: Fizikë
Klasa: VIII

Kapitulli	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënët	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
1.1. Forcat dhe lëvizja (24 orë)	1. Llogaritja e shpejtësisë, e largësisë dhe e kohës	Mësuës/i/a shkruan në dërrasën e zezë fjalët lëvizje dhe prehje . Për 3 minuta nxënësit duhet të shkruajnë sa më shumë fjalë që lidhen me to.	Të nxënët <ul style="list-style-type: none"> ▪ Demonstrim ▪ Veprimtari praktike 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Produkt (poster) ▪ Vëzhgim 	makina lodër, fletë A4 projektor, lap top,
	2. Njësi të tjera të shpejtësisë	Lepuri dhe breshka janë në një garë shpejtësie me njëri-tjetrin. Si mendoni, kush e fiton garën? Pse?	Të nxënët <ul style="list-style-type: none"> ▪ Punë në grup dhe punë individuale 	<ul style="list-style-type: none"> □ Vlerësi 	parnje të trupave që lëvizin: autobusi, treni, aeroplani, parashutisti, sfera eij,
1.2. Drita dhe tingulli	3. Veprimtari praktike. Sa shpejt lëvizni?	Në jetën e përditshme shpesh themi se trupat lëvizin shpejt ose ngadalë. Nxitën nxënësit të tregojnë disa trupa që lëvizin shpejt ose ngadalë.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Diskutim ▪ Lojë me role ▪ Hulumtojmë dhe zbulojmë 	<ul style="list-style-type: none"> □ Vlerësi 	revisita shkencore, vizatime të grafikeve të ndryshëm, teksti <i>Fizika 8</i> , <i>Udhëzues për mësuësin</i> ;
	4. Shpejtësia e insekteve	A keni vëzhguar ndonjëherë insekte që lëvizin? Çfarë ju ka bërë përshtypje? A jeni habitur kur keni parë se sa të vogla janë dhe sa shpejt lëvizin?	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Di, dua të di, mësova ▪ Vëzhgo-analizo-diskuto 	<ul style="list-style-type: none"> □ Vlerësi 	<i>Udhëzues për mësuësin</i> ; <i>Fletore pune për nxënësin</i> ;
	5. Lëvizja njëtrajtësisht e ndryshuar	Shtrohet pyetja: Si ndryshon shpejtësia e lëvizjes së autobusit kur niset nga stacioni dhe derisa mbërrin në stacionin tjetër? Lejohen nxënësit të shprehin mendimet e tyre lirshëm, ashtu si e mendojnë.	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Përvijim i të menduarit ▪ Rishikim në dyshe 	<ul style="list-style-type: none"> □ Vlerësi 	materiale nga interneti; kartonë,
	6. Llogaritja e shpejtësisë mesatare	Jeni duke udhëtuar me makinë dhe shihni vazhdimisht se sa tregon shpejtësimatësi i makinës. A do të ndryshojë shpesh vlera ai? Po në semaforë?	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Siuhi mendimesh ▪ Rrjeti i diskutimit 	<ul style="list-style-type: none"> □ Vetëvl erësim; 	burime drite; objekte të ndryshme,
	7. Sie e ka përshkuar rrugën Albani?	Jeni duke udhëtuar me familjen në Vlorë. Si mund ta përshkruani rrugën që bën makina? A mund ta paraqesim grafikisht mënyrën e lëvizjes së një objekti?	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Mendo, puno në dyshe, diskuto ▪ Rrjeti i diskutimit ▪ Konsolidim i të nxënët 	<ul style="list-style-type: none"> □ Intervis të me një listë treguesish; □ Vëzhgi m me një listë të plotë 	enciklopedi a revista, postera; fotografi; kompjuter;
	8. Shembuj të grafikeve të varësisë largësi-kohë	Shtrohet pyetja: Ç'kuptoni me faktin se një trup lëviz në mënyrë të njëtrajtshme me shpejtësi 7 m/s?	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Rrjeti i diskutimit ▪ Rishikim në dyshe 	<ul style="list-style-type: none"> □ Prezan tim me gojë ose me shkrim, 	telefon, videokasetë, CD interaktive, kabineti i Fizikës
	9. Grafikët e varësisë shpejtësi-kohë	Diskutohet: Kur themi që një trup lëviz me shpejtësi konstante? Ç'loj lëvizjeje kryen ai?	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Zbatime praktike brenda dhe jashtë klase 		
	10. Veprimtari praktike. Llogaritja e shpejtësisë dhe e nxitimit	<i>Shkrim i shpejtë</i> : Shkruani simbollet e këtyre madhësive fizike: <i>rruga, koha, shpejtësia, nxitimi</i> , si dhe simbollet e tyre përkatëse. Veprimtaria zgjat rreth 4-5 minuta.			

	11. Ushtrime	Nisen nga shtëpia dy vëllezër për të vajtur në shkollë. Njeri shkon duke vrapuar dhe tjetri duke ecur. Cili prej tyre shkon më shpejt? A mund ta llogarisni shpejtësinë me të cilën vini në shkollë? Çfarë madhësis na nevojiten?		
	12. Siguria rrugore	Mësuësija shkruan në tabelë Siguria rrugore dhe flon nxënësit të japin mendime në lidhje me të. Më pas paraqiten disa pamje të qarkullimit të makinave dhe të këmbësorëve në rrugë.		
	13. Përsëritje. Lëvizja dhe shpejtësia	Një lojtar gjatë një ndeshjeje futbolli i takon të përkohje një rrugë rreth 12 km. Cila madhësi na duhet për të gjetur shpejtësinë mesatare të lëvizjes së lojtarit?		
	14-15. Projekt. Respektimi i rregullave të qarkullimit rrugor	A keni dëgjuar për monedhën shpërfillëse? Marrim një gotë dhe vendosim një letër bixhozi dhe mbi të një monedhë. Çfarë do të ndodhë me monedhën nëse i japim një goditje letrës?		
	16. Drita, burimet e dritës	Përfytyroni veten tuaj në një dhomë plotësisht të errët. Shoku juaj me një elektrik dorë ndriçon një objekt të dhomës. Çfarë do të shihni në këtë mjedis të errët?		
	17. Përhapja e dritës në vijë të drejtë. Hijet	Kryejmë këtë provë: Marrim një qiri të ndezur dhe dy kartonë me vrimë. Një nxënësi shen flakën nëpërmjet vrimave të dy kartonëve. Zhvendosim pak njërin karton. A mund ta shohim flakën? Kur e shohim?		
	18. Eklipsët	Paraqiten në video-projektor pamje të ndryshme të eklipsit të Diellit dhe të Hënës dhe diskutohet rreth pozicioneve Diell, Tokë, Hënë.		
	19. Vepërtari praktike. Hijet	Një nxënësi formon me duar figura të ndryshme të cilat projektohen në ekran. A varet forma e hijes nga forma e trupit?		
	20. Vepërtari praktike. Përhapja e dritës në hapësirë	Jemi pranë një liqeni me ujë të qetë e të pastër. Ju mund të dalloni qartë gurët në fund të tij. Pse ndodh kjo gjë? Paraqiten pamje të qjellit të natës me video-projektor.		
	21. Vepërtari praktike. Matja e shpejtësisë së dritës	Imagjinoni një kohë me shi. Megjithëse rrufeja ndodh shumë larg, na duket se dritën e shohim në çast. Pse ndodh kjo?		
	22. Përsëritje të njohurive	Një sferë irrokulliset në një ulluk të pjerrët. Zbret me shpejtësi vazhdimisht e më të madhe, kurse ngjitet me shpejtësi gjithnjë e më të vogël. Tregoni një shembull të ngjashëm me këtë.		
	23. Test i tremujorit të parë			
	24. Vlerësim i portofolit të nxënësit	Secili nxënësi mer në bankë punimet e portofolit të tij në tremujorin e parë.		<input type="checkbox"/> Orë të lira <input type="checkbox"/> Detyrë për vlerësim për një grup temash të caktuara: <input type="checkbox"/> Test në përfundim të një kohe të caktuar; <input type="checkbox"/> Vlerësim i portofolit

PLANIFIKIMI I TREMUJORIT TË DYTË (JANAR-MARS)

Fusha: Shkencat e natyrës
Lënda: Fizikë
Klasa: VIII

Kapitulli	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënësve	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet
2. Drita dhe tingulli (28 orë)	25. Pasqyrimi i dritës	Marrim një pasqyrë dhe me anë të saj ndryshojmë drejtimin e një tufë drite. A keni një shpjegim për këtë dukuri?	<input type="checkbox"/> Demonstrim	<input type="checkbox"/> Vëzhgim	pasqyra
	26. Shëmbëllimi në pasqyrën e rrafshët. Shikimi pas kthesave	Oëndrojmë përpata një pasqyre. Çfarë vëmë re para saj? Lëvizni në lidhje me pasqyrën. p.sh., ngrini lart dorën e majtë. Shikoni me kujdes çdo të ndodhë me shëmbëllimin.	<input type="checkbox"/> Veprimtari praktikë	<input type="checkbox"/> (poster) Përgjigje me gojë	thjerri i ndryshme
	27. Përmbledhje. Përsëritje për pasqyrimin e dritës	Shkruhen në tabelë temat: pasqyrë, kënd i rënies, rreze drite, kënd i pasqyrimit, rreze e pasqyruar, shëmbëllim dhe u kërkohet nxënësve të shkruajnë një shkrim të shpejtë.	<input type="checkbox"/> Punë në grup dhe punë individuale	<input type="checkbox"/> Punë në grup	prizma
	28. Përthyerja e dritës	Marrim një gotë qelqi me ujë dhe vendosim brenda saj një lugë. Shikojmë gotën nga sipër. Si duket luga? Heqim lugën dhe në fundin e enës vendosim një monedhë metalike. Në ç'pozicion duket se ndodhet ajo?	<input type="checkbox"/> Diskutim	<input type="checkbox"/> Debat	aparati fotografik
	29. Pasqyrimi i brendshëm i plotë. Zbatimet. Prizmat	Vizatoni një prizëm trekëndor dhe tregoni çfarë figure është baza? Po faqet anësore të tij? Paraqiten në projektor prizma të ndryshëm optikë dhe kalimi i dritës nëpër to.	<input type="checkbox"/> Lojë me role	<input type="checkbox"/> Detyra	tabela mësimore
	30. Thjerrat	Vendosim një xham zmadhues mbi një tufë letrash ose mbi një copë akulli. Çfarë ndodh?	<input type="checkbox"/> Hulumtim dhe zbulim	<input type="checkbox"/> Vetëvlerës	fletë A4
	31. Veprimtari praktikë. Përdorimi i thjerrave	Në natyrë shohim: një pikë vese, copën e qelqit të fenerët e makinave, xhamat e syzeve. Të gjitha këto trupa shërbejnë si thjerri. Nxënësit mund të japin edhe shembuj të tjerë ku përdoren thjerrat, si dylbi, aparate fotografike, mikroskopë etj.	<input type="checkbox"/> Di, dua të di, mësova	<input type="checkbox"/> Intervistë me një listë treguesish	projektor
	32. Funkcionimi i syrit dhe i aparatit fotografik. Kujdesi për sytë	1) Marrim një dhomë të errët dhe në faqen e përparme hapim një vrimë të madhe. Vërejmë shëmbëllimin e një trupi të ndriçuar, në lehtë gjysmë të tejdukshme. 2) Sot do të ndërtojmë një model të thjeshtë të syrit. Një balonë 5 litërshë e mbushim me ujë dhe vendosim në të një thjerrë përmbledhëse. Drejtojmë mbi të dritën që vjen nga një burim dhe do të vëmë re shëmbëlliminë retinë. Ky "sy" nuk ka as iris, as qepalla...	<input type="checkbox"/> Përvijim i analizë-diskutim	<input type="checkbox"/> Prezantim me gojë ose me shkrim	laptop
			<input type="checkbox"/> Përvijim i menduarit	<input type="checkbox"/> me gojë ose me shkrim	kartonë
			<input type="checkbox"/> Rishikim në dyshe	<input type="checkbox"/> Projekt	burime drite
			<input type="checkbox"/> Stuhi mendimesh	<input type="checkbox"/> Detyrë për një grup temash të caktuara	objekte të ndryshme
			<input type="checkbox"/> Rrjeti i diskutimit	<input type="checkbox"/> Test	vizatime të grafikëve të ndryshëm
		<input type="checkbox"/> Zbatime praktike brenda dhe jashtë klasës	<input type="checkbox"/> Portofol	teksti Fizika 8	

	<p>33. <i>Veprimtari praktike.</i> Përthyerja e dritës</p> <p>34. Përsëritje për përthyerjen e dritës</p> <p>35. Pse na duhen ngjyrat? Ngjyrat e objekteve</p> <p>36. Filtrat me ngjyra. Ndryshimi i ngjyrave të objekteve</p> <p>37. <i>Veprimtari praktike.</i> Ngjyrat</p> <p>38. <i>Detyra.</i> Thjerrat <i>Fresnel</i></p> <p>39. <i>Përsëritje.</i> Ngjyrat e dritës</p> <p>40. Prodhi i tingullit</p> <p>41. Vala e zërit. Fortësia dhe lartësia e tingullit</p> <p>42. Dëgjimi i tingullit. Veshi</p> <p>43. <i>Përsëritje.</i> Të dëgjuarit dhe tingulli</p> <p>44. Jehona. Përdorimi i jehonës</p> <p>45. Matja e shpejtësisë së tingullit. Ultratingujt</p> <p>46. <i>Përsëritje.</i> Pasqyrimi i tingullit</p> <p>47. <i>Detyra.</i> Jehona</p>	<p>Mbi faqen e një libri vendosni një pllakë qelqi. Shikoni shkronjat e librit në ndodhen nën pllakë dhe krahasojini me shkronjat e tjera të librit.</p> <p>Formojmë filuska sapuni dhe shohim fytyrën tonë dhe trupa të tjerë përreth aty.</p> <p>Në natyrë qëndrojmë pranë një shatërvani dhe dielli ndodhet prapa nesh. A ju tërheq vëmendjen ndonjë dukuri?</p> <p>Në dhomën e errët, në vend të perdes vendosim bluzën e kuqe dhe e ndriçojmë me dritë të gjelbër. Bluza duket e zezë sepse thith ngjyrën e gjelbër dhe nuk pasqyron asnjë reze në syrin tonë.</p> <p>Demonstrohet rrethi i ngjyrave ku janë ngjyrosur 7 sektorë dhe shihet se gjatë rrotullimit ngjyrat nuk dallohen më dhe rrethi ngjan pothuaj i bardhë.</p> <p>A e keni lexuar librin "Fari në fund të botës" të Zhyl Vernit? Diskutohet më nxënësit rreth 5-6 minuta.</p> <p>Situata të përgatitura nga temat e mëparshme.</p> <p>Dy vizore me madhësi të ndryshme i fiksojmë me shirit ngjites në buzë të tryezës, në mënyrë që të dalin jashtë saj. Bëjini vizoret që të vibrojnë, në fillim të shkuritirën pastaj të gjatën.</p> <p>Mbështjellim një karton në formën e hinkës dhe e fiksojmë me një ngjites shiriti. Dëgjojmë një muzikë me volum të ulët. Anën e ngushtë të hinkës e afrojmë të veshi. Pastaj afrojmë anën e ngushtë të hinkës te goja.</p> <p>Të gjithë e dimë se natën kur është qetësi, tingujt dëgjoohen më mirë. Komentoni shprehjen popullore "nata ka veshë".</p> <p>Shkruhen në tabelë fjalët: tingulli, amplitudë, frekuencë, zhurmë, ndotje akustike dhe u kërkohet nxënësve të shkruajnë një shkrim të shpejtë.</p> <p>Paraqitet me video-projektor pjesë nga filmi "Beni ecën vetë", fragmenti i jehonës.</p> <p>Shikoni dhe interpretoni figurën 2.6 f. 45 në libër.</p> <p>Paraqitni në mënyrë skematike një tingull dhe një zhurmë. Çfarë dallimi vëmë re?</p> <p>Në një numërë ju e përftoni jehonën pas 4 sekondash.</p>		<p>telefon video-kasetë CD interaktive</p>
--	---	--	--	--

				Shpejtësia e zërit në ajër është 340 m/s. Sa e gjerë është humnera?	
48. Veprimtari praktikë. Krijimi i melodive muzikore				Në shkallën <i>do</i> <i>maxhor</i> notat quhen: <i>Do-Re-Mi-Fa-Sol-La-Si-Do</i> . Çdo notë ka një frekuencë më të lartë se nota paraardhëse. Diferenca e frekuencave të dy notave quhet ton muzikor.	
49. Përdorimi dhe rrezizqet që vijnë nga drita dhe tingulli				Jeni në radhën e fundit në një sallë koncerti. Ju shihni më parë goditjen e daullës, pastaj dëgjoni tingullin e saj. Pse ndodh kështu?	
50. Përsëritje. Drita dhe tingulli				Situata të përgatitura nga temat e mëparshme.	
51. Test i tremujorit të dytë					
52. Vlerësim i portofolit të nxënësit				Secili nxënës ka në bankë punimet e portofolit të tij gjatë tremujorit të dytë.	

PLANIFIKIMI I TREMUJORIT TË TRETË (PRILL-QERSHOR)

Fusha: Shkencat e natyrës
Lënda: Fizikë
Klasa: VIII

Kapitulli	Temat mësimore	Situata e parashikuar e të nxënët	Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet	
Drita dhe tingulli Elektriciteti dhe magnetizmi (18 orë)	53. Drita e padukshme	Në verë, në një ditë me diell, lëkura nxihet më shumë në mal se sa në fushë. Pse ndodh kjo?	<input type="checkbox"/> Demonstrim <input type="checkbox"/> Veprimtari praktike <input type="checkbox"/> Punë në grup dhe punë individuale <input type="checkbox"/> Diskutim	<input type="checkbox"/> Vëzhgim <input type="checkbox"/> Produkt (poster) <input type="checkbox"/> Përgjigje me gojë <input type="checkbox"/> Punë në grup <input type="checkbox"/> Debat	magnet shufër magnet nw formw patkoi hekur elektromagnet tabela mësimore pamje nga interneti fletë A4	
	54. Komunikimi	Astronomët i vrojtjnë yjet me pajisje e mjete të ndjeshme ndaj rrezeve të padukshme. Për ç'arsye? Si mendoni?	<input type="checkbox"/> Lojë me role <input type="checkbox"/> Hulimtim dhe zbulim	<input type="checkbox"/> Detyra shpiele <input type="checkbox"/> Vetvlerësim <input type="checkbox"/> Intervistë me një listë	kartona objekte të ndryshme projektor laptop postera fotografi	
	55. Galimi. Përdorimi i rrezeve ultravijollcë	Kur shkojmë në plazh dhe bëjmë banjë dielli, lëkura jonë nxihet. Çfarë e shkakton këtë nxirje?	<input type="checkbox"/> Di, dua të di, mësova <input type="checkbox"/> Vëzhgim-analizë-diskutim	<input type="checkbox"/> Përvijim i të menduarit <input type="checkbox"/> Rishikim në dyshe <input type="checkbox"/> Stuhi mendimesh	<input type="checkbox"/> Prezantim me gojë ose me shkrim, <input type="checkbox"/> Projekt	ndryshëm vizatime të grafikëve të tekstit. <i>Fizika 8</i> <i>Udhëzues për Mësuesin</i>
	56. Përdorimi i rrezeve në mjekësi	Tregohen raste të përdorimit të rrezeve X në aeroport dhe në mjekësi. A ju është dashur ndonjëherë të bëni grafi të dhëmbit? Ç'loj rrezesh e bëjnë të mundur këtë diagnostikim?	<input type="checkbox"/> Paraqiten pamje të sistemit diellor, të Tokës dhe planetëve të tjerë.	<input type="checkbox"/> Zbatime praktike brenda dhe jashtë klasës	<input type="checkbox"/> Detyrë për një grup temash të caktuara <input type="checkbox"/> Test <input type="checkbox"/> Portofol	<i>Fletore Pure</i> për nxënësin materiale nga interneti materiale nga enciklopedi dhe revista shkencore komputer telefon videokasetë, CD interaktive
	57. Vrojtimi i qiellit. Zbatime në astronomi	Paraqiten pamje të sistemit diellor, të Tokës dhe planetëve të tjerë.	<input type="checkbox"/> Tokës dhe planetëve të tjerë.			
	58. Radioastronomia. Astronomia e rrezeve X dhe gama	Paraqitet në projektor një film i shkurtër mbi valët e radios (www.youtube.com/watch?v=sRX2EY5Ublo) dhe diskutohet për njohuritë që nxënësit kanë.	Paraqitet në projektor një film i shkurtër mbi valët e radios (www.youtube.com/watch?v=sRX2EY5Ublo) dhe diskutohet për njohuritë që nxënësit kanë.			
59. Detyra. Imazheria mjekësore	Ju ndodh që gjatë një loje futbolli të ndieni dhimbje në gju. Doktor i ju thotë se mund të keni dëmtuar ligamentet e gjurit. Çfarë iu rekomandon ai?	Ju ndodh që gjatë një loje futbolli të ndieni dhimbje në gju. Doktor i ju thotë se mund të keni dëmtuar ligamentet e gjurit. Çfarë iu rekomandon ai?				
60. Pyetje dhe problema	Situatë për diskutim: Detet dhe liqenet na duken me ngjyrë blu, ndërsa kur marrim ujin e tyre na del që është pa ngjyrë. Ku "humbi" ngjyra?	Situatë për diskutim: Detet dhe liqenet na duken me ngjyrë blu, ndërsa kur marrim ujin e tyre na del që është pa ngjyrë. Ku "humbi" ngjyra?				

	61. Si kthehet hekuri në magnet? Çmagnetizimi i magnetëve. Fusha magnetike	Po t'i afrojmë një ore çeliku me zemberek një magnet, ora mund të mos funksionojë. Disa pjesë përbërëse të saj mund të magnetizohen gjithmonë. Mësuessija u tregon nxënëseve busullën dhe i pyet si funksionon ajo.		
	62. Fusha magnetike e Tokës	Kur shpërndajmë pluhurin e hekurit mbi kartonin e vendosur mbi magnet, pjesa më e madhe e pluhurit përqendrohet te skajet e dy magnetëve, ndërsa një sasi e vogël gjendet rreth pjesëve të tjera. Ç'tregon kjo?		
	63. Përsëritje. Magnetizmi	Për të ndarë mbeturinat prej hekuri e çeliku prej metaleve të tjera, shfrytëzohet fuqia ngritëse e magnetëve të mëdha. Këto materiale më pas riciklohen.		
	64. Fusha magnetike rreth një përçuesi drejtvizor	Ndërtoni një elektromagnet të thjeshtë.		
	65. Ku përdoren elektromagnetet? Releja dhe çelësi magnetik	Eksperimentet tregojnë se fusha magnetike e një bobine rritet shumë kur brenda saj futim një shufër hekuri. Pra, fusha magnetike e krijuar nga një bobinë është më e fuqishme se ajo e krijuar nga një spirë e vetme.		
	66. Veprimtari praktike. Fusha magnetike e magnetit shufër	Paraqiten në projektor pamje të fushës magnetike.		
	67. Detyra. Magnetizmi dhe elektromagnetet	Shkruani në fletore 10 fjalë kyçe në lidhje me elektricitetin dhe magnetizmin.		
	68. Përsëritje. Elektriciteti dhe magnetizmi	Paraqitet harta e koncepteve për elektricitetin dhe magnetizmin dhe diskutohet rreth koncepteve kryesore.		
	69. Test i tremujorit të tretë 70. Vlerësim i portofolit të nxënësit	Secili nxënësi ka në bankë punimet e portofolit të tij gjatë tremujorit të tretë.		

**I. PLANIFIKIMI I ORËVE MËSIMORE
TË TREMUJORIT TË PARË
SHTATOR-DHJETOR**

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE nr. 1

Data _____

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<p>Tema mësimore 1. Llogaritja e shpejtësisë, e largësisë dhe e kohës</p>		<p>Situata e të nxënësve: Mësuesi/ja shkruan në dërrasën e zezë fjalët <i>lëvizje</i> dhe <i>prehje</i>. Për 3 minuta nxënësit duhet të shkruajnë sa më shumë fjalë që lidhen me to.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> Të përkufizojnë shpejtësinë e trupit. Të dallojnë kur një trup kryen lëvizje të njëtrajtshme dhe lëvizje të ndryshuar. Të llogaritin shpejtësinë, largësinë dhe kohën duke përdorur formula. 		<p>Fjalët kyç: shpejtësi, largësi, kohë, simbolet e tyre, lëvizje e njëtrajtshme dhe lëvizje e ndryshuar.</p>	
<p>Mjetet: teksti i nxënësit</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë e nxënësve për lëvizjen në lëndën e Diturisë së Natyrës.</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>			
<p>Diskutim për njohuritë paraprake: Në listën e nxënësve mund të përfshihen fjalë të tilla si: <i>makina, shoferi, vendudodhje, trup referimi, trajektore, kali, kalorësi, piloti, avionit</i> etj. Kur lista të jetë e mjaftueshme, nxënësit punojnë në grupe duke bashkëpunuar dhe synojnë që të sigurojnë të paktën 3 terma për grup. Duke shqyrtuar grupimet, vendosin një emërtim të përshtatshëm, të cilin e përdorin si titull. Secili grup shpjegon arsyet themelore për organizimin e listës. Veprimtaria nxit diskutimin e nxënësve.</p>			
<p>Përvijimi i të menduarit: Mësuesi/ja orienton nxënësit nëpërmjet pyetjeve: <i>Çfarë është shpejtësia? Kur lëvizja quhet e njëtrajtshme? Kur lëvizja quhet e ndryshueshme? Më pas shkruan në tabelë formulat e llogaritjes së shpejtësisë, të largësisë dhe të kohës duke përdorur simbolet përkatëse.</i></p>			
<p>Rishikim në dyshe: Nxënësit punojnë shembullin 1, 2 dhe 3 dhe shkëmbejnë mendimet e tyre për zgjidhjen e ushtrimeve. Mësuesi/ja monitoron punën e tyre dhe jep udhëzimet përkatëse.</p>			
<p>Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit do të vlerësohen për mënyrën e përkufizimit të shpejtësisë së trupit, për dallimin e lëvizjes së njëtrajtshme dhe të lëvizjes së ndryshuar, si edhe për llogaritjen e shpejtësisë, të largësisë dhe të kohës, duke përdorur formulat përkatëse.</p>			
<p>Detyrë shtëpie: Mund t'u jepet nxënësve si detyrë rubrika "?" në faqen 7.</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<p>Tema mësimore 2. Njësi të tjera të shpejtësisë</p>		<p>Situata e të nxënës: <i>Lepuri dhe breshka janë në një garë shpejtësie me njëri-tjetrin. Si mendoni, kush e fiton garën? Pse?</i></p>	
<p>Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> Të tregojnë njësi të ndryshme të rrugës dhe të kohës, për të përcaktuar njësitë e tjera të shpejtësisë. Të njohin lidhjet midis njësive matëse. Të krahasojnë teorikisht shpejtësitë e trupave të ndryshëm. 		<p>Fjalët kyç: njësi matëse të rrugës, të kohës dhe të shpejtësisë.</p>	
<p>Mjetet: teksti i nxënës</p>	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë e nxënësve në lëndën e Biologjisë.</p>		
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>			
<p>Diskutim për njohuritë paraprake: Pyeten nxënësit: <i>A është gjithmonë e përshtatshme që rruga të matet në metër? Pse? Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të sjellin shembuj nga jeta e përditshme. A është gjithmonë e përshtatshme që koha të matet në sekonda?</i></p>			
<p>Mbajtja e strukturuar e shënimeve: Shtrohet pyetja: <i>Cilat janë disa njësi të tjera të shpejtësisë?</i> Punohet në tabelë shembulli 4 dhe udhëzohen nxënësit të mbajnë shënime në fletore në klasës, duke strukturuar të dhënat e ushtrimit, formulën që duhet zbatuar dhe njësinë e shpejtësisë. Më pas nxënësve u kërkohet që këtë shpejtësi ta shprehin në metër për sekondë.</p>			
<p>Rishikim në dyshe: Udhëzohen nxënësit të krijojnë dy ushtrime, ku të përdorin njësi të ndryshme të shpejtësisë dhe ia japin shokut të bankës për ta zgjidhur. Më pas, ata këmbëjnë fletoret dhe kontrollojnë zgjidhjen e njëri-tjetrit.</p>			
<p>Vlerësimi: Në përfundim të mësim, nxënësit vlerësohen për përcaktimin e njësive të shpejtësisë të trupit, për njohjen e lidhjeve midis njësive matëse, si edhe për krahasimin e shpejtësisë të trupave të ndryshëm.</p>			
<p>Detyrë shtëpie: Mund t'u jepet nxënësve si detyrë rubrika “?” në faqen 8 dhe të krijojnë një problemë, ku e panjohur të jetë shpejtësia dhe të shprehet në kilometër për sekondë.</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore. 3. Veprimtari praktike. Sa shpejt lëvizin?			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyç: shpejtësi, largësi, kohë, simbolet e tyre, njësi matëse të rrugës dhe kohës, dhe shpejtësisë.	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Të renditin trupa që lëvizin shpejt ose ngadalë. 2. Të matin largësinë dhe kohën për të llogaritur shpejtësinë mesatare. 3. Të punojnë në grup. 			
Mjetet: metër shirit me gjatësi 50 m, 4 kona plastikë, 6 kronometra.	Li dhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë marrë në lëndën e Diturisë së Natyrës dhe të Fizikës në klasën e shtatë.		
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Bashkëbisedim: Fillimisht mësuesi/ja iu bën të njohur qëllimin e veprimtarisë nxënësve për të llogaritur shpejtësitë e disa shokëve të klasës. Shtrohet pyetjet: <i>Cilat janë madhësitë që na nevojiten për të përcaktuar shpejtësinë? Me çfarë e masim rrugën? Po kohën?</i>			
Kryerja e punës: Ndahen nxënësit në grupe prej 8 vetash, dhe secilit i ndahet detyra. Njëri prej nxënësve kryen lëvizje (vrapuesi) duke ndryshuar ritmin e ecjes nga njëri kon në tjetrin, nxënësi tjetër mban shënime dhe gjashtë nxënësit të pajisur me kronometër matin kohën. Mësuesi/ja udhëzon nxënësit të ndjekin hapat e rubrikës “Metoda” në Fletoren e Punës. Më pas nxënësit grupohen për të llogaritur shpejtësinë mesatare të vrapuesve të grupeve dhe vlerat e matjeve të kryera t’i shënojnë në një tabelë. Diskutohet me nxënësit pse llogaritet shpejtësia mesatare e secilit vrapues në fund të 30 m dhe a kanë kryer matje të sakta për largësinë dhe kohën. <i>Cilat janë gabimet që mund të kenë bërë gjatë punës?</i>			
Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për renditjen e trupave që lëvizin shpejt ose ngadalë, për matjen e largësisë dhe të kohës për të llogaritur shpejtësinë mesatare, si edhe për punën dhe komunikimin në grup.			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<p>Tema mësimore. 4. Shpejtësia e insekteve</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> Të përcaktojnë mënyrën e gjetjes së shpejtësisë së insekteve. Të përdorin mjete të thjeshta për të kryer matje. Të argumentojnë përgjigjet e tyre. 		<p>Fjalët kyç: insekt, shpejtësi, hulumtim.</p>	
<p>Mjetet: pipëz, insekte, metër, kronometër</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë në lëndën e Biologjisë dhe në fushën e zoologjisë.</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>			
<p>Imagjinatë e drejtuar: Mësuesi/ja paraqet një situatë problemore: <i>Imagjini një merimangë që del nga një e çarë e murit, kontrollon për ushqim dhe kthehet me shpejtësi në brendësi të së çarës. Dy fëmijë, Linda dhe Egi, të nxitur nga kureshtja, duan të gjejnë një mënyrë për të gjetur shpejtësinë e lëvizjes së merimangave. Çfarë do t'u sugjeronit ju atyre?</i></p>			
<p>Stuhi pyetjesh: Mësuesi/ja shkruan pyetjet në tabelë: <i>A mund të përdorim një pipëz të gjatë për të parë se cila nga merimangat lëviz më shpejt? Çfarë madhësisish duhet të matim për të gjetur shpejtësinë? Çfarë mjetesh duhet të përdorim për të matur këto madhësi? Si do të veprojmë që prova të jetë e rregullt? A duhet t'i përsërisim disa herë matjet? Pse? Pse bërtiti Egi, kur Linda sugjeroi që, për të matur shpejtësinë e tyre, mund t'i detyronim të kalonim përmes pipëzës? A është etike që hulumtimi të kryhet në këtë mënyrë? Çfarë problemesh mund të dalin nga matjet?</i></p>			
<p>Rishikim në dyshe: Udhëzohen nxënësit t'u japin përgjigje pyetjeve të mësipërme. Më pas ata diskutojnë në dyshe dhe përgjigjet e tyre diskutohen edhe me nxënësit e tjerë.</p>			
<p>Vlerësimi: Në përfundim të mësimit, nxënësit vlerësohen për përcaktimin e mënyrës për gjetjen e shpejtësisë së insekteve, për përdorimin e mjeteve të thjeshta për të kryer matje të madhësive që nevojiten, si edhe për argumentimin e përgjigjeve e tyre.</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<p>Tema mësimore 5. Lëvizja njëtrajtësisht e ndryshuar</p>			
<p>Situata e të nxënësve: Shtrohet pyetja: <i>Si ndryshon shpejtësia e lëvizjes së autobusit kur nisët nga stacioni dhe derisa mbërrin në stacionin tjetër? Lejohen nxënësit të shprehin mendimet e tyre lirshëm, ashtu si e mendojnë.</i></p>			
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të sjellin shembuj trupash që kryejnë lëvizje njëtrajtësisht të ndryshuar. 2. Të përkufizojnë nxitimin në lëvizjen njëtrajtësisht të ndryshuar. 3. Të dallojnë lëvizjen e përsheptuar dhe të ngadalësuar, duke u nisur nga shenja e nxitimit. 			
<p>Mjetet: teksti i nxënësit, lap top,</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë e nxënësve për konceptin e ndryshimit të shpejtësisë gjatë lëvizjes së trupave të marra në klasën e gjashtë.</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>			
<p>Diskutim për njohuritë paraprake: Paraqiten në projektor trupa të ndryshëm që lëvizin, p.sh., një aeroplan ose një tren, topi i hokejit kur rrëshqet mbi akull ose një sferë që rrëshqet mbi dysheme. U kërkohet nxënësve të përshkruajnë si ndryshon shpejtësia gjatë kohës së lëvizjes. Gjatë përshkrimit synohet që të zhvillohet fjalori me terma fizike.</p>			
<p>Përvijimi i të menduarit: U lihet 2-3 minuta kohë nxënësve të mendohen rreth pyetjeve: <i>Sa llojesh është lëvizja e ndryshuar? Cila madhësi rritet apo zvogëlohet? Si mund të përkufizojmë lëvizjen njëtrajtësisht të ndryshuar? Më pas dëgjohen disa prej tyre. Mësuetsija jep përkufizimin e nxitimit dhe shkruan në tabelë formulën, duke treguar se V_0 është shpejtësia fillestare. U tregon nxënësve njësinë e nxitimit dhe së bashku me një nxënës punojnë në tabelë shembullin 5 dhe 6. Nxënësit e tjerë mbajnë shënime në fletoren e klasës.</i></p> <p>Shtrohet pyetja: <i>Çfarë lloj lëvizje është rënia e lirë? Diskutohet shembulli i parashutistit (paraqitet në projektor), i cili po bie me shpejtësi fundore. Çfarë ndodh në çastin kur ai hap parashutën?</i></p>			
<p>Përforcim: Bëhet përmbledhja e njohurive të marra në lidhje me shpejtësinë, lëvizjen e ndryshuar, shpejtësinë mesatare, lëvizjen njëtrajtësisht të ndryshuar; për përkufizimin e nxitimit, si edhe për dallimin e lëvizjes së përsheptuar dhe të ngadalësuar, duke u nisur nga shenja e nxitimit.</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<p>Tema mësimore 6. Llogaritja e shpejtësisë mesatare <i>Detyrë për vlerësim. Fletë Pune 1.3</i></p>		<p>Situata e të nxënit: <i>Jeni duke udhëtuar me makinë dhe shihni vazhdimisht se sa tregon shpejtësimatësi i makinës. A do të ndryshojë shpesh vlera ai? Po në semaforë?</i></p>	
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të shpjegojnë kuptimin fizik të shpejtësisë mesatare. 2. Të njehsojnë shpejtësinë mesatare në lëvizjen e ndryshueshme me anën e formulës së shpejtësisë. 3. Të llogaritin shpejtësinë mesatare në ushtrime që kanë të bëjnë me lëvizjen e ndryshuar. 		<p>Fjalët kyç: shpejtësi mesatare, rrugë kohë, njësi matëse.</p>	
<p>Mjetet: Fletorja e Punës</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë e nxënësve në lëndën e Gjeografisë.</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>			
<p>Diskutim për njohuritë paraprake: Diskutohet me nxënësit si gjendet largësia kur njohim shpejtësinë dhe kohën dhe kur njohim largësinë dhe shpejtësinë. U kërkohet nxënësve të shkruajnë formulat, duke përdorur simbolet përkatëse.</p>			
<p>Praktikë e zbatuar: U shpërndahen nxënësve fletë formati A4 dhe udhëzohen të zgjidhin ushtrimet në <i>Fletën e Punës 1.3</i>. U sillen në vëmendje se duhet të ndjekin të gjitha hapat për zgjidhjen e tyre, duke shkruar më parë të dhënat dhe duke zbatuar formulën dhe në fund duke shënuar njësitë e madhësive fizike. Monitorohet puna e nxënësve për rreth 25 minuta dhe fletët mbledhen për t'u vlerësuar.</p>			
<p>Përforcim: Bëhet një përmbledhje e njohurive të marra në lidhje me shpejtësinë, lëvizjen e ndryshuar dhe shpejtësinë mesatare. U jepet nxënësve një ushtrimi plotësues, si: <i>Një makinë lëviz me shpejtësi mesatare 18 m/s. Sa është rruga që përshkon makina gjatë 10 minutave?</i> Pasi u lihet koha e nevojshme, pyeten nxënësit si arsyetuan për zgjidhjen e tij dhe, në varësi të kohës, ushtrimi zgjidhet në tabelë ose jepet për detyrë shtëpie.</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 7. Si e ka përshkruar rrugën Albani?		Situata e të nxënimit: Jeni duke udhëtuar me familjen në Vlorë. Si mund ta përshkruani rrugën që bën makina? A mund ta paraqesim grafikisht mënyrën e lëvizjes së një objekti?	
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Të përshkruajnë rrugën që bën një trup kur lëviz. 2. Të paraqesin grafikisht varësinë largësi-kohë. 3. Të llogaritin shpejtësinë e trupit me të dhënat e tabelës.		Fjalët kyç: grafiku i varësisë largësi-kohë, shpejtësi, tabelë.	
Mjetet: teksti, tabela me grafikun e varësisë largësi-kohë.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë e nxënësve nga lënda e Matematikës dhe e Gjeografisë. Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve		
Diskutim për njohuritë paraprake: Mësuesi/ja shkruan në tabelë: <i>Si mund të paraqitet grafikisht mënyra e lëvizjes së një objekti? Nxënësit diskutojnë rreth mënyrave që njohin.</i>			
Udhëzuesi i të lexuarit ndërveprues: Ndahet klasa në grupe me nga 4 nxënës dhe udhëzohen që për rreth 10 minuta të lexojnë tekstin. Më pas shkruhen pyetjet në tabelë për secilin grup: 1. Çfarë lëvizjeje ka kryer Albani? Pse? 2. Ç'tregon pjesa A e grafikut? Ku e kuptojmë? 3. Ç'tregon pjesa B e grafikut? Ku e kuptojmë? 4. Ç'tregon pjesa C e grafikut? Ku e kuptojmë? 5. Si janë shpejtësitë në pjesët A dhe C? 6. Në cilën pjesë Albani lëviz me shpejtësi më të madhe? Ku e kuptojmë?			
U lihet 5 minuta kohë nxënësve që t'u përgjigjen pyetjeve të mësipërme dhe fillojnë diskutimet sipas grupeve. Më pas diskutohet rreth figurës 1.7 a, b, c në lidhje me grafikun e varësisë largësi-kohë.			
Rishikim në dyshe: Sipas grupeve nxënësit llogaritin shpejtësinë e lëvizjes së Albanit në secilën pjesë të lëvizjes së tij. Aktivizohen nxënës në tabelë dhe pyeten si arsyetuan duke marrë të dhënat nga tabela. Mësuesi/ja thotë se për të paraqitur grafikisht lëvizjen e objektit përdoren edhe mënyra të tjera.			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<p>Tema mësimore. 8. Shembuj të grafikëve të varësisë largësi-kohë <i>Detjërë për Vlerësim. Fletë Pune 1.4</i></p>			
<p>Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të përcaktojnë vlerën e largësisë dhe kohës nga grafiku. 2. Të llogaritin shpejtësinë mesatare. 3. Të interpretojnë nëpërmjet grafikut llojin e lëvizjes së trupit. 			
<p>Mjetet: Fletë Pune 1.4, fletë formati A4</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë e nxënësve për konceptin e ndryshimit të shpejtësisë gjatë lëvizjes së trupave të zhvilluara në temat e mësipërme.</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>			
<p>Diskutim për njohuritë paraprake: Shtrohet pyetja për diskutim: <i>Cilat janë madhësitë fizike të domosdoshme për të llogaritur shpejtësinë e trupit?</i></p>			
<p>Praktikë e zbatuar: U shpërndahen nxënësve fleta formati A4 dhe udhëzohen të zgjidhin ushtrimet në Fletën e Punës 1.4. U sillen në vëmendje se duhet të shkruajnë përgjigje të plota dhe të sakta, duke i argumentuar ato. Monitorohet puna e nxënësve për rreth 25 minuta dhe në fund fletët mbledhen për t'u vlerësuar.</p>			
<p>Përforsim: Bëhet një përmbledhje e njohurive të marra në lidhje me shpejtësinë, paraqitjen grafike të varësisë largësi-kohë dhe shpejtësinë mesatare. U jepet nxënësve ushtrimi plotësues i mëposhtëm: <i>Një makinë lëviz me shpejtësi mesatare 36 km/h, kurse një tjetër me shpejtësi 10 m/s. Cila prej tyre ka shpejtësi më të madhe? Pasi iu lihet koha e nevojshme, nxënësit pyeten si arsyetuan për zgjidhjen e ushtrimit dhe, në varësi të orës së mësimin, ushtrimi zgjidhet në tabelë ose jepet si detyrë shtëpie.</i></p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 9. Grafikët e varësisë shpejtësi-kohë			
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Të ndërtojnë grafikun e lëvizjes së një objekti me shpejtësi konstante. 2. Të analizojnë tabelën 2 dhe figurën 1.9. 3. Të interpretojnë grafikët e varësisë së shpejtësisë nga koha. 			
Mjetet: teksti i nxënësit	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë e nxënësve në lëndën e matematikës.		
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Di - Dua të di - Mësova: Udhëzohen nxënësit të ndërtojnë grafikun e varësisë shpejtësi-kohë për një traktor, i cili lëviz me shpejtësi 6 m/s. <i>Si është ky grafik?</i>			
Di - Dua të di - Mësova: Shtrohet pyetja për diskutim: <i>Po kur trupi, gjatë një intervali të caktuar kohe e ndryshon shpejtësinë? Udhëzohen nxënësit të lexojnë tekstin për të analizuar tabelën 2 dhe figurën 1.9. U kërkohet të bëjnë një përshkrim të lëvizjes së një rrëshqitëseje me rula. Çfarë mund të themi për nxitimin kur shpejtësia zvogëlohet? Më pas vijohet me interpretimin e grafikëve në figurën 1.11 dhe bëhet dallimi midis lëvizjes së përshpejtuar dhe asaj të ngadalësuar.</i>			
Di - Dua të di - Mësova: Bëhet një përmbledhje e njohurive të marra në lidhje me shpejtësinë, lëvizjen e ndryshuar, shpejtësinë mesatare, lëvizjen njëtrajtësisht të ndryshuar, jepet përkufizimi i nxitimit si edhe dallimi i lëvizjes së përshpejtuar dhe të ngadalësuar, duke u nisur nga shenja e nxitimit.			
Detyrë shtëpie Mund t'u jepet nxënësve si detyrë rubrika “?” në faqen 13.			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<p>Tema mësimore 10. Veprimtari praktike. Llogaritja e shpejtësisë dhe e nxitimit <i>Detyrë për vlerësim. Fletore Pune 1.5</i></p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> Të përcaktojnë formulën që nevojitet për të llogaritur madhësinë e panjohur. Të llogarisin shpejtësinë mesatare. Të vendosin saktë njësitë e madhësive fizike. 			
<p>Mjetet: Fletë Pune 1.5, fletë formati A4</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë e nxënësve për temat e zhvilluara më sipër.</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>			
<p>Diskutim për njohuritë paraprake: Shtrohet pyetja për diskutim: <i>Cilat janë madhësitë fizike të domosdoshme për të llogaritur nxitimin e trupit?</i> Nxënësit shprehën në lidhje me to dhe mësuësja i shkruan në tabelë. Më pas një nxënës shkruan formulën e plotë të nxitimit.</p>			
<p>Praktikë e zbatuar: U shpërndahen nxënësve fletë formati A4 dhe udhëzohen të zgjidhin ushtrimet në <i>Fletën e Punës 1.5</i>. U sillen në vëmendje se duhet të shkruajnë përgjigje të plota dhe të sakta duke i argumentuar ato dhe të vendosin saktë njësitë e madhësive fizike. Monitorohet puna e nxënësve për rreth 30 minuta dhe fletët mbliqhen për t'u vlerësuar.</p>			
<p>Përforsim: U sillen në kujtesë nxënësve se gjatë orës së ardhshme do të vijojnë me zgjidhjen e ushtrimeve, për të komentuar dhe për të shpjeguar paqartësitë gjatë zhvillimit të temave mësimore që kanë të bëjnë me rrugën, kohën, shpejtësinë, nxitimin, simbolet e njësitë përkatëse, si edhe formulat për llogaritjen e tyre.</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 11. Ushtrime			
Situata e të nxënimit: <i>Nisen nga shtëpia dy vëllezër për të vajtur në shkollë. Njëri shkon duke vrapuar dhe tjetri duke ecur. Cili prej tyre shkon më shpejt? A mund ta llogarisni shpejtësinë me të cilën vini në shkollë? Çfarë madhësih na nevojiten?</i>			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyç: shpejtësi, nxitim, grafikët e varësisë largësi-kohë dhe shpejtësi-kohë, njësi matëse.	
<ol style="list-style-type: none"> Të llogaritin vlerën e shpejtësisë dhe nxitimit. Të interpretojnë grafikët e varësisë largësi-kohë dhe shpejtësi-kohë. Të argumentojnë përgjigjet e tyre. 			
Mjetet: teksti i nxënësit, Fleta e Punës 1.5, tabela të grafikëve.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë marrë në temat e zhvilluara.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<p>Stuhi pyetjesh: Diskutohet situata e të nxënimit dhe theksohet se i pari arrin më përpara në shkollë, sepse të njëjtën rrugë e bën për një kohë më të shkurtër. Më pas shtohen për diskutim me nxënësit pyetjet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Çfarë paraqet grafikun <i>i varësisë largësi kohë</i>? - Çfarë tregon vijat <i>e drejtë horizontale në grafik</i>? <i>Po vijat e lakuar</i>? - Çfarë paraqet grafikun <i>i varësisë shpejtësi - kohë</i>? - Çfarë tregon vijat <i>e drejtë horizontale në grafik</i>? - <i>A mund të dallojmë llojin e lëvizjes duke u nisur nga shenja e nxitimit</i>? <p>Aktivizohen nxënësit të niveleve të ndryshme dhe nxiten të shprehin mendimet e tyre lirshëm.</p>			
<p>Përvijim i të menduarit: Paraqiten tabelat e grafikëve të varësisë largësi-kohë dhe shpejtësi-kohë dhe u kërkohet nxënësve të bëjnë interpretimin e tyre, duke u bazuar edhe në ato çka thanë në sipër. Më pas udhëzohen të punojnë ushtrime 1, 2, 3 në faqen 15 në tekst. Ata duhet të argumentojnë përgjigjet e tyre.</p>			
<p>Vlerësimi: Në përfundim të mësimit, nxënësit do të vlerësohen për llogaritjen e vlerës së shpejtësisë dhe të nxitimit, për interpretimin e grafikëve të varësisë largësi-kohë dhe shpejtësi-kohë, si edhe për argumentimin e përgjigjeve e tyre.</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 12. Siguria rrugore		<p>Situata e të nxënësve: Mësuesi/ja shkruan në tabelë <i>Siguria rrugore</i> dhe fton nxënësit të japin mendime në lidhje me të. Më pas paraqiten disa pamje të qarkullimit të makinave dhe të këmbësorëve në rrugë.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënësve sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> Të përkufizojnë inercinë dhe ligjin e parë të Njutonit. Të përkufizojnë kohën e reagimit, largësinë e reagimit, të frenimit dhe të ndalimit. Të orientohen drejt në situata reale. 		<p>Fjalët kyç: koha e reagimit dhe largësia e reagimit, e frenimit dhe e ndalimit, inercia, masa.</p>	
<p>Mjetet: teksti i nxënësit, lap top, projektor.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që kanë nxënësit në lëndën e edukimit qytetar dhe TIK.</p>	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<p>Imagjinatë e drejtuar: Mësuesi/ja paraqet një situatë problemore: <i>Imagjini një garë me kuaj. Një kalë është duke vrapuar me shpejtësi dhe, papritur, ndalon. Çfarë do të ndodhë me kalorësin? Diskutimi zgjat rreth 3-4 minuta. Arrihet në përfundimin se çfarë është inercia dhe nxënësit sjellin shembuj të tjerë të ngjashëm nga jeta reale. Më pas përkufizohet dukuria e inercisë dhe ligji i parë të Njutonit.</i></p>			
<p>Udhëzuesit e të lexuarit ndërvprues: Në këtë fazë mësuesi/ja udhëzon nxënësit për një lexim produktiv të tekstit, duke bërë të kuptohet koha e reagimit dhe largësia e reagimit, e frenimit dhe e ndalimit. Më pas nxënësit punojnë me tekstin dhe në fletore shkruajnë përgjigjet për pyetjet e dhëna.</p>			
<p>Risikim në dyshe: Udhëzohen nxënësit të punojnë ushtrimin e mëposhtëm:</p> <p><i>Në një autostradë, shpejtësia maksimale e lejuar është 130 km/h në kohë të thatë dhe 110 km/h në kohë me shi. Dy pika të kontrollit të policisë rrugore janë 250 km larg njëra-tjetrës.</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <i>Në automjetet e ka përshkruar këtë largësi për 1 orë e 20 minuta. Nëse ju do të ishit punonjës i policisë rrugore, a do ta gjobisnit drejtuesin e automjetit? Si e argumentoni këtë fakt?</i> <i>Një automjet tjetër e përshkoi këtë largësi në një ditë shiu për 2 orë e 30 minuta. A i ka shkelur rregullat e qarkullimit drejtuesi i automjetit? Nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin për përgjigjet e gjetura dhe më pas diskutimet zhvillohen me të gjithë klasën.</i> 			
<p>Vlerësimi: Në përfundim të mesimit nxënësit vlerësohen për përkufizimin e inercisë dhe përkufizimin e ligjit të parë të Njutonit, të kohës së reagimit, largësisë së reagimit, të frenimit dhe të ndalimit, si edhe për orientimin drejt në situata reale.</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore. 13. Përsëritje. Lëvizja dhe shpejtësia			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Të përcaktojnë formulën që nevojitet për të llogaritur madhësinë e panjohur. 2. Të krahasojnë shpejtësitë e trupave të ndryshëm. 3. Të vendosin saktë njësitë e madhësive fizike.			
Mjetet: teksti Fizika 8, faqe 18, 19, laps, vizore, fletë formati A4.	Fjalët kyç: shpejtësi mesatare, largësi, kohë, nxitim, njësi.		
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë e nxënësve për lojën e futbollit dhe të lëndës së Edukimit Fizik.			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Diskutim për njohuritë paraprake: Nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin në lidhje me situatën e të nxënimit dhe një nxënës shkruan formulën në tabelë. Mësuesi/ja u kërkon nxënësve të sjellin shembuj të tjerë lëvizjesh të ndryshueshme. Si gjendet shpejtësia mesatare e një trupi që lëviz në mënyrë të ndryshueshme? Mund të bëhet një hartë koncepti me konceptet kryesore.			
Praktikë e zbatuar: U shpërndahen nxënësve fletë formati A4 dhe udhëzohen të zgjidhin ushtrimet në faqen 18 dhe 19 të tekstit. Ata ndahen në dy grupe dhe punojnë në mënyrë të pavarur; grupi A punon ushtrimet me numër tek dhe grupi B ushtrimet me numër çift. U risillet në vëmendje se duhet të shkruajnë përgjigje të plota dhe të sakta, duke i argumentuar ato dhe të vendosin saktë njësitë e madhësive fizike. Monitorohet puna e nxënësve për rreth 30 minuta dhe më pas aktivizohen nxënës në tabelë për të paraqitur zgjidhjet e tyre.			
Përforsim: Nxiten nxënësit të marrin pjesë për të paraqitur zgjidhjet e tyre dhe të jenë të vëmendshëm për të bërë korrigjime të mundshme të përgjigjeve që japin shokët e grupit dhe informohen se në orën vijuese do të zhvillojnë një bisedë me një punonjës të policisë rrugore.			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<p>Tema mësimore 14-15. Projekt. Respektimi i rregullave të qarkullimit rrugor</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Bisedë me një punonjës të policisë rrugore 2. Ndërtimi i një posteri me rregullat e qarkullimit rrugor 		<p>Situata e të nxënit: <i>A keni dëgjuar për monedhën shpërfillëse? Marrim një gotë dhe vendosim një letër bixhozi dhe mbi të një monedhë. Çfarë do të ndodhë me monedhën nëse i japim një goditje letrës?</i></p>	
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të diskutojnë rreth dukurisë së inercisë. 2. Të paraqesin materiale dhe informacione rreth sigurisë rrugore. 3. Të tregojnë ç'janë makinat e sigurta. 		<p>Fjalët kyç: inerci, kod rrugor, largësi e frenimit etj.</p>	
<p>Mjetet: Fletore Pune 1.5, fletë formati A4, vizatime e krijime të nxënësve, monedhë, një letër bixhozi, gotë.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë e nxënësve në lëndën e Edukimit Qytetar dhe Teknologjisë së Informacionit, si dhe me lëndën e Edukimit Figurativ.</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>			
<p>Ora I. Diskutim për njohuritë paraprake: Nxënësit diskutojnë lirisht për njohuritë që kanë rreth konceptit të inercisë. Ndër shumë trupa në natyrë, inercia haset edhe te mjetet e transportit. Kur mjetet e transportit nisen me shpejtësi të madhe, udhëtarëve u duket sikur i “tërheq” dikush nga pas. Po kështu, nëse automjeti që është duke lëvizur, frenon papritur, trupat e udhëtarëve zhvendosen përpara. Kjo gjë mund të vërë në rrezik jetën e udhëtarëve në këtë automjet, prandaj duhen zbatuar disa rregulla të caktuara, si p.sh., vendosja e rripit të sigurimit. Për këtë qëllim është ftuar për të biseduar një punonjës i policisë rrugore.</p>			
<p>Praktikë e zbatuar: Zhvillohet biseda me punonjës in e policisë rrugore. Kjo bisedë duhet fokusuar te rregullat e kodit rrugor dhe kryesisht në shkaqet e aksidenteve rrugore.</p>			
<p>Ora II. Informohen nxënësit që një orë më parë se do të punojnë për krijimin e një tabele, ku të pasqyrohen rregullat e qarkullimit rrugor, në mënyrë që ata të grumbullojnë materiale informuese dhe figurative. Të ndarë në grupe i përzgjedhin materialet dhe i grupojnë sipas temës së secilit grup (p.sh. për këmbësorët, për çiklistët, për automjetet etj.). Ata punojnë duke diskutuar e duke treguar për ngjarje nga jeta e përditshme, për të cilat kanë dëgjuar nga të afërmit a nga mediat. Nxiten nxënësit të bëjnë vizatime, duke krijuar postera me synime ndërgjegjësimi për përdoruesit e rrugës. Në përfundim, nxënësit paraqesin tabelat që punuan. Mësuesi/ja motivon nxënësit që kanë qenë më aktivë në diskutime dhe ata që kanë paraqitur krijime e vizatime në lidhje me temën.</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 16. Drita, burimet e dritës			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyç: drita, burime drite, trupa të ndriçuar.	
1. Të tregojnë se kur dhe pse i shohim trupat.			
2. Të tregojnë ç'është drita.			
3. Të klasifikojnë trupat në varësi të dritës që ata kanë.			
Mjetet: teksti i nxënësit, elektrik dore, objekte të ndryshme.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë marrë në lëndën e Diturisë së Natyrës.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Marrëdhëniet pyetje-përgjigje: U kërkohet nxënësve të renditin njohuritë që ata kanë për dritën, duke i orientuar të thonë se çfarë është drita dhe si përhapet ajo. U drejtohen nxënësve pyetjet e mëposhtme: <i>A është drita shkaku i ndijimit tonë të të parit? Ciliët trupa shohim? Çfarë i shkakton drita e diellit enës me ujë? A themi se ajo zotëron energji? Si përhapet ajo?</i>			
Përmbledhja pohim-mbështetje: Udhëzohen nxënësit që për rreth 5 minuta të lexojnë tekstin dhe më pas bëhet një diskutim i hapur se ashtu si drita edhe tingulli është formë e energjisë.			
POHIM: Drita është valë energjie.			
MBËSHTEJTJE e FAKTE: Vala e dritës është tërthore, sepse grimcat e mjedisit lëkunden pingul me drejtimin sipas të cilit ajo përhapet.			
Vizatohet figura në tabelë dhe më pas sillen shembuj të burimeve të dritës dhe të trupave të ndriçuar duke cilësuar pse quhen të tillë.			
Rishikim në dyshe: Udhëzohen nxënësit të nënvijëzojnë me një vijë burimet e drite dhe me dy vija trupat e ndriçuar; <i>dielli, toka, pasqyra, hëna, flaka e zjarrit, rrufeja, syri, reja, ekrani i kompjuterit.</i>			
Vlerësimi: Në përfundim të mësimit, nxënësit vlerësohen për shpjegimin se kur dhe pse i shohim trupat, për përkufizimin e dritës, si edhe për klasifikimin e trupave në varësi të dritës që ata kanë.			
Detyrë shtëpie e sugjeruar: Në një dhomë të errët Dritani i drejton fenerin Shpëtimt. Kë do të shihni, Dritanin apo Shpëtimin? Pse?			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<p>Tema mësimore 17. Përhapja e dritës në vijë të drejtë. Hijet</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të tregojnë mënyrën e përhapjes së dritës. 2. Të kryejnë eksperimente të thjeshta për të arritur në përfundime. 3. Të përkufizojnë hijen e plotë dhe gjysmëhijen. 		<p>Fjalët kyç: hije e plotë, gjysmëhije, dritë.</p>	
<p>Mjetet: llambë elektrike, një tub plastik 20-25 cm, dy kartonë me vrimë, qiri, sferë jo e tejdukshme.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë marrë në lëndën e Diturisë së Natyrës.</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>			
<p>Praktikë e drejtuar: Kryejmë eksperimentet e mëposhtme.</p> <p>Eksperimenti 1. Marrim një tub plastik 20-25 cm të gjatë dhe nëpërmjet tij shohim llambën elektrike të ndezur. E përkulim tubin pa e shkëputur nga syri dhe përpiqemi të shohim llambën përmes tij. <i>A mund ta shohim? Pse? Në ç'përfundim arrijmë? Eksperimenti</i></p> <p>2. Marrim një perde dhe e ndriçojmë nga një burim pikësor drite. Midis tyre vendosim një sferë të patejdukshme. <i>Çfarë do të vëmë re në perde? Çfarë përfundimi nxjerrim?</i></p>			
<p>Përvijim i të menduarit: Udhëzohen nxënësit të lexojnë tekstin për rreth 5-6 minuta. Më pas ata pyeten: <i>Si përhapet drita? Çfarë quhet reze drite? Ç'janë hijet? Kur hija e formuar quhet e plotë? Çfarë quhet gjysmëhije?</i></p>			
<p>Rishikim në dyshe: Nxënësit u japin përgjigje pyetjeve të mësipërme. Ata mund të plotësojnë njëri-tjetrin. Më pas shtrohet për diskutim pyetja e mëposhtme: <i>Gjatë transmetimit në televizion të një ndeshjeje futbolli që zhvillohet natën, duket që lojtarët nuk kanë vetëm një hije, por disa. Pse ndodh kjo? Nxënësit japin mendime dhe plotësojnë njëri-tjetrin.</i></p>			
<p>Vlerësimi: Në përfundim të mesimit, nxënësit vlerësohen për përcaktimin e mënyrës së përhapjes së dritës, kryerjen e eksperimenteve të thjeshta për të arritur në përfundime të rëndësishme, si edhe për përkufizimin e hijes së plotë dhe të gjysmëhijes.</p>			
<p>Detyrë shtëpie e sugjeruar: Si mund të krahasoni lartësinë e trupave nga gjatësia e hijeve të tyre në një ditë me diell? Vizatojeni figurën.</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 18. Eklipsët		Situata e të nxënësve: Paraqiten në video-projektor pamje të ndryshme të eklipsit të Diellit dhe të Hënës dhe diskutohet rreth pozicioneve Diell, Tokë, Hënë.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Të përkufizojnë eklipsët si dukuri natyrore. 2. Të njohin karakteristikat e eklipsit të diellit. 3. Të njohin karakteristikat e eklipsit të hënës.		Fjalët kyç: eklips, diell, hënë.	
Mjetet: teksti Fizika VIII, tabela mësimore të eklipsit të Diellit e të Hënës, lap top, video-projektor.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë marrë në lëndën e Fizikës së klasës së shtatë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<p>Parashikim nga temat paraprakë: Mësuesi/ja shkruan në tabelë fjalën <i>eklips</i> dhe fton nxënësit të shkruajnë ato që dinë në lidhje me këtë dukuri natyrore astronomike. Diskutohet se në të kaluarën eklipsi i Diellit ngjallte shumë frikë te njerëzit e paditur, ndërsa sot është një dukuri shumë interesante dhe për njerëzit mbetet mbresëlënëse.</p> <p>Udhëzuesi për të lexuarit ndërveprues: Udhëzohen nxënësit të lexojnë tekstin, për 3-4 minuta, e më pas pyeten: <i>Çfarë janë eklipsët? Cila është vendosja e planetëve për të pasur eklipsin e Diellit apo të Hënës?</i></p> <p>Rishikim në dyshe: Në këtë fazë nxënësit punojnë në fletoren e klasës. Ata ndajnë dy kolona dhe shkruajnë në secilën kolonë karakteristikat e eklipsit të Diellit dhe të Hënës.</p> <p>Vlerësimi: Në përfundim të mësimit, nxënësit do të vlerësohen për përkufizimin e eklipseve si dukuri natyrore, për njohjen e karakteristikave të eklipsit të Diellit dhe të Hënës.</p> <p>Detyrë shtëpie e sugjeruar: Gjeni materiale të tjera plotësuese në lidhje me eklipsin e Diellit dhe të Hënës dhe paraqitini ato në tabelë me dy kolona.</p>			


Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 19. Veprimtari praktike. Hijet			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyç: hija dhe gjysmëhija	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Të përkufizojnë hijen dhe gjysmëhijen. 2. Të tregojnë faktorët që ndikojnë në formimin e hijes dhe gjysmëhijes. 3. Të punojnë në grup për të plotësuar tabela dhe për të ndërtuar grafikë. 			
Mjetet: Fletë Pune 2.2, burim drite, letër, gërshërë, vizore ose metër, ekran për të projektuar hijen.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë marrë në lëndën e Diturisë së Natyrës dhe të Matematikës.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Diskutim i njohurive paraprake: Diskutohet me nxënësit situata e të nxënit duke shtruar pyetjen: <i>Çfarë vëmë re kur rritet largësia e burimit nga trupi p.sh., nga duart tona? Po kur zvogëlohet largësia e trupit nga ekranit? Arrihet në përfundimin se forma e hijes varet nga forma e trupit, sepse drita përhapet në vijë të drejtë.</i>			
Praktikë e drejtuar: Mësuesi/ja ndan nxënësit në grupe. Secili grup ka mjetet e tij dhe secili nxënës ka rolin e tij. Udhëzohen të përdorin një mënyrë për të shënuar se sa e qartë apo e zbehtë është hija, p.sh., një shkallë nga 1 deri në 5. Nxënësit plotësojnë në grup rezultatet për matjet e kryera dhe ndërtojnë një grafik të varësisë të zmadhimit të hijes-largësi nga ekrani. Këshillohen të punojnë në qetësi dhe të respektojnë njëri-tjetrin.			
Punë individuale: Në këtë fazë nxënësit mund të punojnë në mënyrë individuale rubrikën “Shqyrtimi i rezultateve. Përfundimet”.			
Vlerësimi: Në përfundim të mësimit, nxënësit vlerësohen për përkufizimin e hijes dhe të gjysmëhijes, për renditjen e faktorëve që ndikojnë në formimin e hijes dhe gjysmëhijes, si edhe punën në grup për të plotësuar tabela dhe për të ndërtuar grafikë.			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<p>Tema mësimore 20. Veprimtari praktike. Përhapja e dritës në hapësirë</p>			
<p>Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> Të vizatojnë pamje të qiellit të natës. Të interpretojnë vizatimet e tyre. Të llogaritin kohën që i duhet dritës për të përshkruar një largësi të caktuar. 			
<p>Mjetet: Fletë Pune 2.3, pamje të ndryshme të qiellit, lap top, projektor.</p>		<p>Fjalët kyç: dritë, shpejtësi, teleskop, njësi të largësive të mëdha, p.sh., vit dritë etj.</p>	
<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë në lëndën e Edukimit Figurativ dhe të Gjeografisë.</p>			
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>			
<p>Diskutim i njohurive paraprake: Diskutohet rreth situatës së të nxënimit dhe u kërkohet nxënësve të tregojnë se në cilat mjedise të tjera përhapet drita. Nga ana tjetër drita e diellit, duke përshkruar hapësirën diell-tokë, përhapet në zbrazëti dhe në ajër.</p>			
<p>Përvijim i të menduarit: Shtrohet pyetja: <i>Çfarë mjeti mund të përdorim, në mënyrë që objektet që ndodhen larg të na duken afër? Ju njihni teleskopin dhe dylbinë.</i> Udhëzohen nxënësit të vizatojnë pamje të qiellit të natës. Më pas ata pyeten se si mund ta vrojtojmë secilin prej tyre.</p>			
<p>Rishikim në dyshe: Në këtë fazë nxënësit punojnë në dyshe për të zgjidhur ushtrimet 3 dhe 4. Pasi u lihet koha e nevojshme, aktivizohen nxënës në tabelë për të paraqitur zgjidhjet. Ata pyeten si arsyetuan dhe argumentojnë mendimin.</p>			
<p>Vlerësimi: Në përfundim të mesimit, nxënësit vlerësohen për vizatimet e pamjeve të qiellit të natës, për interpretimin e tyre dhe për llogaritjen e kohës që i duhet dritës për të përshkruar një largësi relativisht shumë të madhe.</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<p>Tema mësimore 21. <i>Veprimtari praktike.</i> Matja e shpejtësisë së dritës</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të tregojnë një mënyrë për matjen e shpejtësisë së dritës. 2. Të tregojnë në cilat mjedise përhapet drita. 3. Të zgjidhin ushtrime me situata të jetës reale. 		<p>Fjalët kyç: dritë, shpejtësi, mjedis.</p>	
<p>Mjetet: Fletë Pune 2.4</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë nga Dituria e Natyrës dhe Matematika.</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>			
<p>Lexim i drejtuar: Udhëzohen nxënësit të lexojnë materialin në Fletë pune 2. 4. Pasi u lihet koha e nevojshme, ata pyeten: <i>Cilat janë mënyrat që përdoren shkencëtarët për matjen e shpejtësisë së dritës? A janë përmirësuar metodat e kryerjes së eksperimenteve me kalimin e kohës?</i></p>			
<p>Përvijim i të menduarit: Diskutohet me nxënësit tabela në faqen 27 në lidhje me shkallën e pasaktësisë së vlerës. <i>Cila është vlera e përhapjes së shpejtësisë së dritës? Arrihet në një përfundim in e përbashkët se drita përhapet me shpejtësi shumë të madhe. Në zbrazëti shpejtësia e përhapjes është 300 mijë km/s. Afërsisht po kaq është edhe shpejtësia e përhapjes së saj në ajër. Si është shpejtësia e dritës në mjedise të ndryshme (p.sh., në ujë apo në qelq)?</i></p>			
<p>Rishikim në dyshe: Udhëzohen nxënësit të punojnë në fletoren e klasës ushtrimet e rubrikës “Pyetje”. Ata diskutojnë në dyshe dhe më pas një nxënës aktivizohet në tabelë për të diskutuar zgjidhjet me të gjithë klasën. Pyetet si arsyetoi për të arritur në përfundime të sakta. Nxënësit e tjerë plotësojnë.</p>			
<p>Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për përcaktimin e mënyrës për matjen e shpejtësisë së dritës dhe arsyetimin në zgjidhjen e detyrave me situata nga jeta reale.</p>			
<p>Detyrë shtëpie e sugjeruar: Në qoftë se një veturë do të lëvizte me shpejtësi 300 km/h, sa ditë do t’i duheshin afërsisht për të përshkruar largësinë që drita e bën në 1 sekondë?</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<p>Tema mësimore 22. Përsëritje e njohurive</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> Të tregojnë cili është shkaku që bën trupin të ndryshojë shpejtësinë e tij Të dallojnë llojet e lëvizjeve të trupave. Të gjejnë madhësitë fizike nëpërmjet grafikëve. 		<p>Fjalët kyç: shpejtësi e trupit, shpejtësi, kohë, rrugë.</p>	
<p>Mjetet: sferë, ulluk i pjerrët, harta e koncepteve.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë në lëndën e Fizikës.</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>			
<p>Diskutim i ideve: Diskutohet me nxënësit në lidhje me njohuritë kryesore të kapitullit: njësitë e ndryshme të shpejtësisë, llogaritja e shpejtësisë mesatare, gjetja e largësisë që ka përshkruar një objekt, ndërtimi i grafikut të varësisë largësi-kohë, shpejtësi-kohë, shpejtësisë fundore, përcaktimi i lëvizjes së objektit me anë të grafikut dhe shpjegimi me anë të shembujve të ligjit të parë të Njutonit.</p>			
<p>Rrjeti i diskutimit: Me përgjigjet e nxënësve formohet harta e koncepteve (shihni në faqen pasardhëse). Më pas kalohet në interpretimin e grafikëve, p.sh., diskutohet nëse grafiku i varësisë largësi-kohë është një vijë e drejtë horizontale, çfarë mund të themi për shpejtësinë e objektit etj.</p>			
<p>Rishikim në dyshe: Punohen ushtrime për llogaritjen e shpejtësisë mesatare dhe të nxitimit, duke përdorur njësitë përkatëse. Gjithashtu këmbëngulet që nxënësi të përdorë simbolet e madhësisë fizike dhe të orientohet saktë në shndërrimin e njësisë.</p>			
<p>Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për përcaktimin e shkaktit që e bën trupin të ndryshojë shpejtësinë e tij, për dallimin e llojeve të lëvizjeve të trupave, si edhe për gjetjen e vlerës së madhësisë fizike nëpërmjet grafikëve.</p>			

Forca dhe lëvizja



Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 23. Test i tremujorit të parë (Shtator-Dhjetor)			
Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
<ol style="list-style-type: none"> Të identifikojnë lloje të ndryshme lëvizjesh e të dallojnë ndryshimin midis tyre. Të njehsojnë shpejtësinë, rrugën, kohën dhe nxitimin. 			
Mjetet: testet parapërgatiten në fletë formati A4.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Ky test formulohet në bazë të njohurive të fituara nga nxënësit në lëndën e Fizikës gjatë tremujorit të parë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<p>Një model testi ndodhet në rubrikën “Shtojcë”.</p> <p>Kriteret e hartimit të testit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Identifikimi i problemit e zgjidhja 40%, - përdorimi i mjeteve praktike dhe situatave reale 40%, - shkrimi në terminologjinë e fizikës 20%. <p>Testi është i pajisur edhe me tabelën e pikëve për vlerësim.</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 24. Vlerësim i portofolit të nxënësit			
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyç: panair, portofol.	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Të përshkruajnë shkurtimisht përmbajtjen e portofolit. 2. Të evidentojnë punimet më të realizuara. 3. Të vlerësojnë rëndësinë e plotësimit të portofolit. 			
Mjetet: detyrat e punuara në klasë, në shtëpi, projekte dhe materiale të tjera.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: kjo orë mësimi lidhet me njohuritë e nxënësve me Artin Pamor, TIK, si dhe me gjuhën dhe komunikimin.		
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve:			
<p>Nxënësit punojnë në grupe dyshe, duke vëzhguar portofolin e njëri-tjetrit. Secili nxënës mban shënime për punimet më të mira dhe ato që duhen përmirësuar, duke përdorur një shkallë vlerësimi nga 1-5. Më pas secili shpreh vlerësimet e tij për portofolin e shokut.</p> <p>Nxënësit, të cilët kanë mangësi të detyrave ose detyra për të përmirësuar, mund të plotësojnë ato në shtëpi.</p> <p>Në fund mësuesi/ja bën një vlerësim të portofolave më të mirë të klasës.</p> <p>Diskutohet me nxënësit rreth detyrave që i kanë realizuar me më shumë dëshirë dhe çfarë do të donin të përmirësonin gjatë periudhës në vazhdim.</p>			

**II. PLANIFIKIMI I ORËVE MËSIMORE
TË TREMUJORIT TË DYTË
JANAR-MARS**

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 1. Pasqyrimi i dritës			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Të përshkruajnë dukurinë e pasqyrimin të dritës. 2. Të formulojnë ligjet e pasqyrimin të dritës. 3. Të shpjegojnë pasqyrimin difuziv dhe të rregullt. 			
Mjetet: teksti, tabela të pasqyrimin të dritës, pasqyra.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë marrë në lëndën e Diturisë së Natyrës.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Diskutim i njohurive paraprake: Diskutohet rreth situatës së të nxënimit dhe arrihet në përfundimin se çdo sipërfaqe pasqyron dritën që bie në të, prandaj i shohim trupat e ndryshëm. Kjo dukuri quhet pasqyrim i dritës.			
Marrëdhëniet pyetje përgjigje: Mësuesi/ja vizaton figurën 2.9 në tabelë dhe së bashku me nxënësit përkufizojnë termat: <i>rreze rënëse, rreze pasqyruese, kënd i rënies dhe kënd i pasqyrimin.</i> Kërkon nga nxënësit të tregojnë sipërfaqe të tjera që shërbejnë si pasqyrë e rrafshët. Ata mund të përmendin sipërfaqen e ujit të qetë, sipërfaqen e një pllake xhami të lëmuar, sipërfaqen e pasqyrës etj. Ata u përgjigjen pyetjeve, si: <i>A e pasqyrojnë njëllot dritën të gjitha sipërfaqet? Shpjegohet pasqyrimi difuziv dhe ai i rregullt.</i>			
Rishikim në dyshe: Udhëzohen nxënësit t'u japin përgjigje pyetjeve të mësipërme. Më pas ata diskutojnë në dyshe dhe përgjigjet e tyre diskutohen edhe me nxënësit e tjerë.			
Vlerësimi: Në përfundim të mësimin nxënësit vlerësohen për përshkrimin e dukurive të pasqyrimin të dritës, për formulimin e ligjeve të pasqyrimin të dritës, si edhe për shpjegimin e pasqyrimin difuziv dhe të rregullt.			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE nr. 2

Data _____

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<p>Tema mësimore 2. Shëmbëllimi në pasqyrën e rrafshët. Shikimi pas kthesave</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të renditin disa karakteristika të shëmbëllimit në pasqyrën e rrafshët. 2. Të përkufizojnë shëmbëllimin real dhe shëmbëllimin virtual. 3. Të vizatojnë rrugën e rrezes së dritës nga objekti deri në syrin tonë. 		<p>Fjalët kyç: shëmbëllim real dhe shëmbëllim virtual, periskop.</p>	
<p>Mjetet: pasqyrë e rrafshët, objekte të ndryshme, fletë formati A4, vizore, laps.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë marrë në lëndën e Edukimit Figurativ dhe të Diturisë së Natyrës.</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>			
<p>Diskutim i njohurive paraprake: Diskutohet në lidhje me situatën e të nxënit dhe arrihet në përfundimin se shëmbëllimi është i anasjelltë me trupin. Më pas jepet përkufizimi i shëmbëllimit real dhe shëmbëllimit virtual. Nxënësit renditin disa karakteristika të tjera të shëmbëllimit në pasqyrën e rrafshët dhe mësuesi/ja i shkruan ato në tabelë.</p>			
<p>Lexim përmbledhje në dyshe. Në këtë fazë të mësimit, udhëzohen nxënësit të lexojnë paragrafin “Shikimi pas kthesave”. Më pas pyeten: Si arrijmë të shohim objektet pas pengesave? Sa është këndi i pasqyrimit të rrezes së dritës, kur këndi i rënies është 45°? Si duhen vendosur pasqyrat?</p>			
<p>Punë individuale: U kërkohet nxënësve të vizatojnë në fletoren e klasës rrugën e rrezes së dritës nga objekti që ndodhet pas pengesës deri në syrin tonë, duke iu referuar figurës 2.13.</p>			
<p>Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për renditjen e disa karakteristikave të shëmbëllimit në pasqyrën e rrafshët për përkufizimin e shëmbëllimit real dhe shëmbëllimit virtual, si edhe për vizatimin e rrugës së rrezes së dritës nga objekti deri në syrin tonë.</p>			
<p>Detyrë shtëpie e sugjeruar: Në shtëpi, nxënësve mund t’u jepet detyrë të ndërtojnë një periskop të thjeshtë.</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 3. Përmbledhje. Përsëritje për pasqyrimin e dritës		Situata e të nxënësve: Shkruhen në tabelë termat: <i>pasqyrë, kënd i rënies, rreze drite, kënd i pasqyrimin, rreze e pasqyruar, shëmbëllim</i> dhe u kërkohet nxënësve të shkruajnë një shkrim të shpejtë.	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Të krijojnë fjalë të sakta fizike me fjalët e dhëna. 2. Të tregojnë se pasqyrimi i dritës bëhet sipas dy ligjeve 3. Të zbatojnë njohuritë në ushtrime dhe situata reale.		Fjalët kyç: pasqyrë, kënd i rënies, rreze drite, kënd i pasqyrimin, shëmbëllim, rreze e pasqyruar.	
Mjetet: teksti Fizika 8, fletë formati A4, vizore, laps.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë marrë në lëndën e Matematikës dhe të Edukimit Figurativ.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Diskutim i njohurive paraprake: Lexohen disa prej shkrimeve të tyre. Më pas u kërkohet nxënësve të formulojnë ligjet e pasqyrimin të dritës duke bërë edhe një përmbledhje të njohurive kryesore mbi pasqyrimin e dritës.			
Përvijim i të menduarit: Pasi mësuesi/ja bindet që njohuritë kryesore janë përvetësuar, orienton nxënësit drejt zgjidhjes së ushtrimeve 1-5 të rubrikës “Pyetje”. Duhet të tregojnë kujdes në ushtrimin 4 për të përcaktuar saktë këndin e pasqyrimin, nisur nga përkufizimi i tij dhe këndin e plotë. U lë kohën e nevojshme dhe aktivizon nxënës të niveleve të ndryshme për të dhënë përgjigjet e tyre. Diskutimet shtrihen në të gjithë klasën.			
Punë në dyshe: Në këtë fazë, nxënësit punojnë në dyshe ushtrimin 6. Ata diskutojnë me njëri-tjetrin se ku duhen vendosur pasqyrat për të parë makinat e tjera në rrugë. Udhëzohen që skica të vizatohet më vizore dhe laps. Tregohen para nxënësve idetë në skicat më të sakta.			
Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për krijimin e fjalive të sakta fizike, për formulimin e dy ligjeve të pasqyrimin të dritës, si edhe për zbatimin e njohurive në ushtrime dhe situata reale.			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 4. Përthyerja e dritës			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> Të përshkruajnë një eksperiment për dukurinë e përthyerjes së dritës. Të formulojnë ligjet e përthyerjes së dritës. Të krahasojnë këndin e rënies dhe këndin e përthyerjes kur drita kalon nga një mjedis në një tjetër. 			
Mjetet: gotë qelqi, lugë, ene qelqi me fund të gjerë, pllakë të bardhë, ujë, elektrik, laps, vizore.	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë në lëndën e Matematikës dhe të Edukimit Figurativ.</p> <p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>		
<p>Diskutim i njohurive paraprake: Diskutohet me nxënësit rreth situatës së të nxënit: Arrihet në përfundimin se kur drita ndryshon mjedis, pra nga ajri në ujë ajo përthyeret pra ndryshon drejtimin e saj, prandaj luga e zhytur në gotën me ujë duket e thyer dhe monedha duket e zhvendosur më lart. Jepen përkufizimet e rrezes rënëse, rrezes së përthyer, këndit të rënies dhe këndit të përthyerjes. (Figura është vizatuar më parë në tabelë).</p> <p>Kërkim hulumtim. Zhvillohet eksperimenti i mëposhtëm nga dy nxënës (me udhëzimet e mësuases): <i>Marrim një ene qelqi me fund të gjerë. Vendosim pingul me fundin e enës një pllakë të bardhë, në të cilën janë shënuar dy boshte pingule. Hedhim ujë deri në nivelin e boshtit horizontal. Me anë të një elektriku lëshojmë një rreze deri sa ajo të shtrihet në pllakë dhe të kalojë në pikën e prerjes së boshteve. Vrojtjmë me kujdes. Çfarë na tregon eksperimenti? Si janë këndi i rënies dhe këndi i përthyerjes? Nga vëzhgimi dhe hulumtimi formulohen së bashku me nxënësit dy ligjet e përthyerjes së dritës.</i></p> <p>Punë individuale: Udhëzohen nxënësit të vizatojnë rrugën e rrezes së dritës kur drita kalon nga ajri në qelq dhe nga qelqi në ajër. Mësuasi/ja monitoron punën dhe jep udhëzimet përkatëse.</p> <p>Vlerësimi: Në përfundim të mesimit nxënësit vlerësohen për shpjegimin e dukurisë e përthyerjes së dritës, për formulimin e ligjeve të përthyerjes së dritës, si edhe për vizatimin e rrugës së rrezeve të dritës kur drita ndryshon mjedis.</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<p>Tema mësimore 5. Pasqyrimi i brendshëm i plotë. Zbatimet. Prizmat</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të shpjegojnë pasqyrimin e brendshëm të plotë. 2. Të tregojnë se çfarë ndodh me kalimin e rrezeve të dritës nëpër prizëm. 3. Të vizatojnë rrugën e rrezeve të dritës në periskopin prizmatik. 			
<p>Mjetet: teksti Fizika 8, fletë A4, laps vizore, lap top, projektor</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë marrë në fushën e Matematikës.</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>			
<p>Diskutim i njohurive paraprake: Nga eksperimenti në orën e kaluar formulam dy ligjet e përthyerjes së dritës. Diskutohet rreth tyre. <i>Çfarë ndodh kur këndi i rënies rritet gradualisht?</i> Shpjegohet me anë të një figure se kur ndodh pasqyrimi i brendshëm i plotë dhe tregohet se ç'kuptohet me kënd kritik.</p>			
<p>Lexim i drejtuar: Udhëzohen nxënësit të lexojnë nënçshifjen “Prizmat”. Diskutohet për periskopin prizmatik dhe për dritat sinjalizuese. Mësuksi/ja fton nxënësit të përshkruajnë rrugën e rrezeve të dritës dhe ta vizatojnë atë të periskopi prizmatik. Më pas diskutohet për pyetjen: <i>Sa herë përthyeret rrezja e dritës gjatë kalimit në prizëm?</i> Nxënësit lexojnë në tekst pjesën për fibrat optike dhe evidentojnë faktin se në një fibër optike drita pëson pasqyrim të brendshëm të plotë.</p>			
<p>Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për shpjegimin e pasqyrimin të brendshëm të plotë, për përshkrimin se çfarë ndodh me kalimin e rrezeve të dritës nëpër prizëm, si edhe për vizatimin e rrugës së rrezeve të dritës në periskopin prizmatik.</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 6. Thjerrat		Situata e të nxënimit: Vendosi një xham zmadhues mbi një tufë letrash ose mbi një copë akulli. <i>Çfarë ndodh?</i>	
<p>Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> Të tregojnë vetitë që gëzojnë thjerrat. Të dallojnë thjerrat përmbledhëse nga ato shpërndarëse. Të përkufizojnë karakteristikat e thjerrave. 			
<p>Mjetet: teksti Fizika 8, qiri, shkrepe, karton i zi, vizore, thjerrë përmbledhëse, thjerrë shpërndarëse.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë marrë në lëndën e Diturisë së Natyrës dhe në fushën e kinematografisë.</p>	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<p>Imagjinatë e drejtuar: Diskutohet rreth situatës së të nxënimit, ku nxënësit përgjigjen se letrat digjen, ndërsa akulli shkrin. Ata mund të tregojnë se kanë lexuar në libra se është djegur varka vetëm se rrezet e diellit kalonin nëpër një xham të madh zmadhues. Evidentohet thjerra përmbledhëse, e cila i mbledh rrezet në një pikë që quhet vatër.</p>			
<p>Mbajja e strukturuar e shënimeve: Nxënësit ndahen në dy grupe. Secili grup vendos në vijë të drejtë sendet: qiriun e ndezur, njërin prej xhamave dhe kartonin. Ata duhet ta përftojnë shëmbëllimin e flakës në karton. Përfaqësues të grupeve të tjera ngrënë pyetje, si:</p> <p><i>Pse kur përdorim thjerrë përmbledhëse përftojmë dy shëmbëllime, të zvoqëluar dhe të zmadhuar?</i></p> <p><i>Pse kur qiriu ndodhet shumë afër thjerrës nuk përftohet shëmbëllim? etj.</i></p> <p>Më pas nxënësit strukturojnë njohuritë e tyre, duke i plotësuar ato edhe me karakteristikat e thjerrave.</p>			
<p>Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për përkufizimin e karakteristikave të thjerrave, për vetinë që gëzojnë thjerrat, si dhe për dallimin e thjerrave përmbledhëse nga ato shpërndarëse.</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<p>Tema mësimore 7. Veprimtari praktike. Përdorimi i thjerrave</p>			
<p>Situata e të nxënësve: Në natyrë shohim: një pikë vese, copën e qelqit të fenerët e makinave, xhamat e syzeve. Të gjitha këto trupa shërbejnë si thjerra. Nxënësit mund të japin edhe shembuj të tjerë ku përdoren thjerrat, si dylbi, aparate fotografike, mikroskopë etj.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> Të njohin thjerrat si pajisje optike dhe funksionin e tyre. Të tregojnë ç'është vatra e një thjerre. Të tregojnë lidhjen midis largësisë së thjerrës nga ekrani dhe objektit nga thjerra me largësisë vatrore. Të punojnë në grup për të shqyrtuar rezultatet. 			
<p>Mjetet: Fletë Pune 2.8, thjerra, mbajtës thjerrash, gërshërë, vizore rreth 2 metër e gjatë, copë kartoni, ekran për të projektuar figurën, thjerra të ndryshme, burim drite.</p>		<p>Fjalët kyç: thjerra, funksion i thjerrave, largësi vatrore, largësi e objektit nga thjerra, largësi e ekranit nga thjerra.</p>	
<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë marrë mbi thjerrat dhe me njohuritë praktike të tyre.</p>			
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>			
<p>Vrojtojmë, analizojmë, diskutojmë: Nxënësit përdorin thjerra (lupa) të llojeve të ndryshme për të vëzhguar sende të imta a sipërfaqe ose fletë me shkrime të imët. Mësuesja i pyet: <i>A duhet të gjejmë një pozicion të caktuar të thjerrës për të lexuar më qartë? Si ndryshojnë llojet e thjerrave në varësi të përdorimeve të tyre?</i></p>			
<p>Praktikë e drejtuar: Të ndarë sipas grupeve, nxënësve iu shpjegohet metoda për gjetjen e largësisë vatrore të thjerrës dhe udhëzohen të mbajnë shënime. Më pas ata ndjekin hapat për matjen e thjerrave duke bërë më parë edhe parashikime të largësisë midis thjerrës dhe ekranit dhe duke përsëritur matjet. Ata orientohen të krijojnë një tabelë dhe të vizatojnë grafikun ku të pasqyrohen rezultatet e matjeve. Në vijim mësuesja shkruan në tabelë lidhjen midis këtyre largësive dhe largësisë vatrore të thjerrës.</p>			
<p>Punë në dyshe: Nxënësit shqyrtojnë rezultatet e matjeve dhe nxjerrin përfundimet duke u bazuar te pyetjet 3 dhe 4 të fletës së punës.</p>			
<p>Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për njohjen e thjerrave dhe funksionin e tyre për projektimin që ajo të kryejë funksionin e saj si edhe për lidhjen midis karakteristikave të thjerrës dhe punën në grup</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<p>Tema mësimore 8. Funkcionimi i syrit dhe i aparatit fotografik. Kujdesi për sytë</p>			
<p>Situata e të nxënimit: 1) Marrim një dhomë të errët dhe në faqen e përparme hapim një vrimë të madhe. Vërejmë shëmbëllimin e një trupi të ndriçuar, në letër gjysmë të tejdukshme.</p> <p>2) Sot do të ndërtojmë një model të thjeshtë të syrit: <i>Një balonë 5 litërshe e mbushim me ujë dhe vendosim në të një thjerrë përmbledhëse. Drejtojmë mbi të dritën që vjen nga një burim dhe do të vëmë re shëmbëllimin në retinë. Ky "sy" nuk ka as iris, as qepalla...</i></p>			
<p>Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>1. Të tregojnë pjesët përbërëse të aparatit fotografik.</p> <p>2. Të tregojnë si është i ndërtuar syri.</p> <p>3. Të shpjegojnë funksionimin e syrit duke analizuar situatë të ngjashme.</p> <p>4. Të listojnë rregullat që duhen për të pasur sy të shëndetshëm.</p>			
<p>Mjetet: teksti Fizika 8, dhomë e errët, objekte të ndryshme, balonë 5 litërshe, ujë, thjerrë përmbledhëse, burim drite.</p>		<p>Fjalët kyç: funksionim i syrit, aparat fotografik, analizë e situatave të ngjashme, të parët, kontroll mjekësor, syze dielli.</p>	
<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë marrë në lëndën e Diturisë së Natyrës dhe Afësismit Teknologjik, lëndën e Biologjisë dhe të Fizikës së klasës së 6.</p>			
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>			
<p>Hulumtojmë dhe zbulojmë: Diskutohet me nxënësit situata e të nxënimit nr. 1: Vëmë re se shëmbëllimi është i turbullt, por me më shumë dritë. Po të vendosim para vrimës një thjerrë përmbledhëse, nxënësit venë re se shëmbëllimi do të jetë me më shumë dritë dhe shumë i qartë. Tani, në vend të letrës së tejdukshme vendosim një film dhe kemi ndërtuar një <i>aparat fotografik</i>. Diskutohet me nxënësit situata e të nxënimit nr. 2.</p>			
<p>Udhëzuesit e të lexuarit ndërveprues: Udhëzohen nxënësit të lexojnë tekstin. Të kuptohet cilat janë pjesët përbërëse të aparatit fotografik dhe si funksionon ai.</p> <p>Nxënësit punojnë në dyshe me tekstin dhe fletoret e klasës për të bërë analizën e situatave të ngjashme të ndërtimi dhe funksionimi i syrit.</p> <p>Te syri rolin e <i>objektivit</i> e luan <i>kristalthei</i>, që ngjan me një thjerrë përmbledhëse, kurse rolin e <i>filmit fotografik</i> e luan <i>njolla e verdhë</i>, e cila përbën pjesën më të ndjeshme të retinës ndaj dritës. <i>Çfarë duhet të kemi parasysh për të ruajtur të parit?</i></p> <p>Diskutohet me nxënësit dhe theksohet fakti se për të lexuar pa na u lodhur sytë, duhet të respektojmë largësinë prej 25 cm. U kërkohen</p>			

nxënësve të listojnë disa rregulla që duhen pasur parasysh për të mbrojtur sytë në veprimtari të tjera të jetës së përditshme (Kujtojmë nga klasa e shtatë si mund ta vrojtojmë eklipsin e diellit.) Sigurisht diskutohet edhe në lidhje me një ushqyerje të shëndetshme dhe për ushqimet e dobishme për shqisën e të parit.

Aktivizohen nxënës në tabelë dhe shkruajnë me radhë mendimet e tyre. Ata pyeten se cilat janë masat që duhen marrë për të ruajtur të parët.

Punë individuale: Udhëzohen nxënësit të vizatojnë një tabelë ku të plotësojnë në mënyrë të përmbledhur njohuritë për funksionimin e syrit dhe aparatit fotografik duke vënë në dukje ngjashmëritë dhe ndryshimet midis tyre.

Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për demonstrimin e pjesëve përbërëse të aparatit fotografik, shpjegimin e përbërjes dhe funksionimit të të parit, për krahasimin mes aparatit fotografik dhe syrit, si dhe për renditjen e rregullave që duhen për të pasur sy të shëndetshëm.

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<p>Tema mësimore 9. Veprimtari praktike. Përthyerja e dritës (Orë për vlerësim portofoli)</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të tregojnë elementët e një thjerre. 2. Të tregojnë si ndahen thjerrat nga funksioni i tyre. 3. Të përshkruajnë ç'ndodh me dritën kur kalon nga një mjedis optik më pak të dendur në një mjedis optik më të dendur. 		<p>Fjalët kyç: bosht optik, vatër, largësi vatrore, thjerra përmbledhëse, thjerra shpërndarëse.</p>	
<p>Mjetet: Fletë Pune 2.6, fletë formati A4.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë teorike dhe praktike të nxënësve për përthyerjen e dritës.</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>			
<p>Veprimtari e pavarur: Puna gjatë kësaj ore veprimtare do të zhvillohet në fletë formati A4.</p>			
<p>Veprimtaria 1: Me fjalët: bosht optik, vatër, largësi vatrore, thjerra përmbledhëse, thjerra shpërndarëse shkruani një shkrim të shkurtër. Tërhiqet vëmendja që nxënësit të ndërtojnë shprehje të sakta fizike.</p>			
<p>Veprimtaria 2: Udhëzohen nxënësit t'u japin përgjigje pyetjeve të fletës së punës 2.6. Pasi iu lihet koha e nevojshme, fletët kontrollohen, vlerësohen dhe vendosen në portofolin e nxënësve.</p>			
<p>Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për shpjegimin e elementeve të një thjerre, për dallimin e llojeve të thjerrave sipas funksionit të tyre dhe për përshkrimin e dukurisë që ndodh me dritën kur kalon nga një mjedis optik më pak të dendur në një mjedis optik më të dendur .</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<p>Tema mësimore 10. Përsëritje për përthyerjen e dritës (Orë për vlerësim të vazhdueshëm)</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> Të vizatojnë rrezet e dritës në situatë të ndryshme reale. Të shpjegojnë se dukuria e përthyerjes së dritës zbatohet te prizmat dhe thjerrat Të përcaktojnë se kur ndodh pasqyrimi i brendshëm i plotë. 		<p>Fjalët kyç: rrezet e dritës, dukuri e përthyerjes së dritës, prizma, thjerra.</p>	
<p>Mjetet: teksti Fizika 8, vizore, laps, tabela e hartës së koncepteve.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë marrë në mësimet e zhvilluara për përthyerjen e dritës.</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>			
<p>Diskutim i njohurive paraprake: Bëhet një përmbledhje e njohurive kryesore që nxënësit kanë marrë gjatë studimit të përthyerjes së dritës. Mësuesi/ja mund të vizatojë në tabelë një hartë koncepti, ku të përmbliken mendimet e nxënësve.</p>			
<p>Praktikë e drejtuar: Udhëzohen nxënësit të punojnë në fletoren e klasës ushtrimet në faqen 34 të tekstit dhe t'i argumentojnë përgjigjet e tyre. Aktivizohen nxënës në tabelë për të dhënë përgjigjet dhe nxënësit e tjerë qëndrojnë të vëmendshëm që ta plotësojnë ose ta korrigjojnë. Në ushtrimin 7 nxënësve u kërkohet të vizatojnë një figurë ku të paraqesin rrugën e rrezes së dritës.</p>			
<p>Vlerësimi: Në përfundim të mesimit nxënësit vlerësohen për vizatimin e rrezeve të dritës në situata të ndryshme, për zbatimin e dukurisë së përthyerjes së dritës te prizmat dhe te thjerrat, si dhe për përcaktimin e këndit të rënies te pasqyrimi i brendshëm i plotë.</p>			
<p>Detyrë shtëpie e sugjeruar: Çfarë pasqyre përdorin mjekët gjatë një vizite mjekësore, kur duan të ndriçojnë pjesët e brendshme të syrit, të veshit, të hundës? Argumentoni përgjigjet tuaja.</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 11. Pse na duhen ngjyrat? Ngjyra e objekteve			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Të shpjegojnë ç'është drita e bardhë dhe përbërësit e saj. 2. Të kryejnë eksperimente që na bindin se ngjyra e një trupi përcaktohet nga ngjyra e rrezes që ai pasqyron në syrin tonë. 3. Të shpjegojnë mënyrën se si shihen ngjyrat e trupave.			
Mjetet: teksti Fizika 8 , fener, perde e bardhë, prizëm optik, elektrik dore me drita shumëngjyrëshe.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë në lëndën e Edukimit Figurativ dhe të Diturisë së Natyrës.		
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<p>Hulumtojmë dhe zbulojmë: Kryejmë eksperimentin e mëposhtëm: Midis fenerit (para të cilit ka një çarje të ngushtë) dhe perdes së bardhë vendosim një prizëm optik. Një nxënës dërgon mbi prizmin një tufë drite. <i>Çfarë vëmë re në perde? Brezi shumëngjyrësh, a është i njëjtë me atë që pamë te shatërrani?</i> Nxiten nxënësit të tregojnë raste të tjera në natyrë kur e kanë vënë re këtë dukuri. Ata mund të tregojnë p.sh., se një dukuri të fillë e kanë vënë re edhe kur kanë qëndruar pranë një ujëvare apo te pistoletat ujitëse. Nxënësit hulumtojnë për të parë se në cilën renditje janë vendosur ngjyrat. Ata arrijnë në një përfundim të përbashkët se ngjyrat janë vendosur në këtë renditje: <i>e kuqe, portokalli, e verdhë, e gjelbër, e kaltër, blu e errët, vjollcë.</i></p> <p>Udhëzues i të lexuarit ndërveprues: Udhëzohen nxënësit të lexojnë tekstin për disa minuta. Më pas ata pyeten se kur drita quhet e bardhë dhe çfarë quhet <i>spektër i dritës së bardhë. Çfarë mund të themi për dritën e diellit dhe për dritën e llambave elektrike?</i></p> <p>Praktikë e drejtuar: Errësojmë klasën. Një nxënës drejton një tufë drite në ekranin e bardhë. <i>Si do t'ju duket perçja?</i> Një tjetër drejton mbi ekran një tufë drite të kuqe. Nxënësi i tretë një tufë drite të gjelbër. <i>Si duket perçja?</i> Nga eksperimenti nxjerrim përfundimin se: Ngjyra e një trupi përcaktohet nga ngjyra e rrezes që ai pasqyron në syrin tonë. Kur trupi pasqyron në syrin tonë të shtata ngjyrat, ai duket i bardhë (eksperimenti 1). Komentojmë fig. 2.26. <i>Pse banania duket e verdhë?</i></p> <p>Detyrë shtëpie e sugjeruar: Të gjithë keni parë ylberin. Përgjiguni pyetjeve: 1. Pse shfaqet ylberit? 2. Kur ndodh kjo dukuri? 3. Kush e luan rolin e prizmit?</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 12. Filtrat me ngjyra. Ndryshimi i ngjyrave të objekteve			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyç: filtrat me ngjyra, ngjytrat e objekteve.	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Të tregojnë nga se varet ngjyra e një trupi. 2. Të tregojnë si veprojmë për të marrë drita me ngjyra të ndryshme. 3. Të shpjegojnë situata të jetës reale që kanë të bëjnë me ngjytrat e objekteve. 			
Mjetet: dhomë e errët, ekran i bardhë, elektrik dore me drita shumëngjyrëshe, objekte me ngjyra të ndryshme.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë marrë kanë në lëndën e Edukimit Figurativ dhe të Diturisë së Natyrës.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<p>Diskutim i njohurive paraprake: Nxënësit kanë njohuri mbi dritën e bardhë dhe përbërësit e saj dhe për mënyrën se si shihen ngjytrat e trupave. Për të marrë drita me ngjyra të ndryshme, përdoren filtra, të cilat lejojnë vetëm ngjyra të veçanta të kalojnë midis tyre, p.sh., filtri i kuq lejon të kalojnë vetëm rrezet e kuqe etj.</p> <p>Udhëzuesi për të lexuarit ndërveprues: Udhëzohen nxënësit të lexojnë tekstin. Më pas ata diskutojnë si duken veshjet e Edrinit dhe Dalinës në dritë të bardhë dhe në dritë blu. Nëpërmjet diskutimit ata binden se objektet pasqyrojnë ngjyrën e pigmentit që ato kanë. Shtrohet pyetja: <i>Kur një objekt do të duket me ngjyrë të zezë?</i> Nxënësit mund të shohin më tepër material në adresën e internetit www.fizik.si.</p> <p>Rishikim në dyshe: Nxënësit punojnë ushtrimet 1, 2, 3 në fletoren e klasës. Më pas ata këmbëjnë fletoret me njëri-tjetrin dhe vlerësojnë përgjigjet e dhëna.</p> <p>Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për përcaktimin e ngjyrës së një trupi, për mënyrën si veprojmë për të marrë drita me ngjyra të ndryshme, si edhe për shpjegimin e ngjyrës së trupave në situata të jetës reale.</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 13. <i>Veprimtari praktike</i> . Ngjytrat		Situata e të nxënimit: Demonstrrohet rrethi i ngjyrave ku janë ngjyrosur 7 sektorë dhe shihet se gjatë rrotullimit ngjytrat nuk dallohen më dhe rrethi ngjan pothuaj i bardhë.	
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Të formojnë zaret e ngjyrave. 2. Të tregojnë si formohen ngjytrat. 3. Të punojnë në grup për të paraqitur kombinimet e ngjyrave.		Fjalët kyç: ngjyra e dritës, ngjyra e objektit.	
Mjetet: Fletë Pune 2.7, rrethi i ngjyrave, fletë kartoni, lapsa me ngjyra, ngjitës, gërshtë.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë e Edukimit Figurativ dhe të Matematikës.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<p>Diskutim i njohurive paraprake: Nxënësit ndahen në grupe dhe punojnë sipas udhëzimeve të fletës së punës 2.7 për të formuar kube me ngjyra. Mësuesi/ja monitoron punën e tyre dhe udhëzon nxënësit se etiketat me germa të vogla përfaqësojnë ngjyrën e burimit të dritës, kurse ato me germa të mëdha ngjyrën e objektit.</p> <p>Praktikë e drejtuar: Nxënësit veprojnë sipas udhëzimeve të mësuesit dhe vendosin me kujdes çfarë ngjyre do të marrë objekti. Ata orientohen që kombinimet t'i paraqesin në një tabelë. Nxënësit mund të shohin më tepër material në adresën e internetit www.fizik.si.</p> <p>Vlerësimi: Në përfundim të veprimtarisë nxënësit vlerësohen për të mënyrën e formimit të zareve të ngjyrave, për punën në grup duke të paraqitur kombinimet e ngjyrave në tabelë.</p> <p>Detyrë shtëpie e sugjeruar:</p> <ol style="list-style-type: none"> Krijoni filluska me shkumë sapuni dhe vëreni në to zbërthimin e dritës së bardhë. Hidhni në tokë vaj makine dhe vëreni zbërthimin e dritës së diellit. 			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE nr. 14

Data _____

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 14. Detyra. Thjerrrat <i>Fresnel</i>		Situata e të nxëniet: <i>A e keni lexuar librin "Fari në fund të botës" të Zhyl Vernit? Diskutohet më nxënësit rreth 5-6 minuta.</i>	
Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Të tregojnë si lindi ideja e përdorimit të thjerrave. 2. Të krahasojnë thjerrrat <i>Fresnel</i> me thjerrrat tradicionale. 3. Të tregojnë me anë të një figure se thyerja e rrezeve kryhet vetëm nga pjesa e lakuar e thjerrave.		Fjalët kyç: thjerra, thjerra <i>Fresnel</i> , seksione të thjerrës, filtra me ngjyra, ngjyrat e objekteve.	
Mjetet: Fletë Pune 2.9, thjerra, fletë A4, laps, vizore, kompjuter me internet.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë në lëndën e Edukimit Figurativ dhe në fushën e shkencave shoqërore.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Marrëdhënie pyetje përgjigje: Udhëzohen nxënësit të lexojnë Fletën e Punës 2.9. Më pas ata pyeten: <i>Si u zëvendësuan me thjerrat pasqyrat që reflektonin dritën në det? Çfarë vetie kishin ato? A ishte i lehtë ndërtimi dhe montimi i thjerrave të një fari? Pse?</i>			
Praktikë e drejtuar: Mësuesi/ja fton nxënësit të vizatojnë figurën e shpërndarjes së rrezeve të dritës nga llamba. Më pas ata tregojnë përparësitë e thjerrave <i>Fresnel</i> në krahasim me thjerrat tradicionale.			
Punë individuale: Nxënësit punojnë në punë individuale në fletoren e klasës, për t'u dhënë përgjigje pyetjeve pas detyrës.			
Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për mënyrën si lindi ideja e përdorimit të thjerrave, për krahasimin e thjerrave <i>Fresnel</i> me ato tradicionale, si edhe për ndërtimin e një figure ku tregohet se thyerja e rrezeve kryhet vetëm nga pjesa e lakuar e thjerrave.			
Kujtesë: Mësuesja njofton nxënësit se në orën e ardhshme do të zhvillohet përsëritje në lidhje me ngjyrat e dritës. Nxënësit duhet të kenë përsëritur njohuritë e tyre mbi ngjyrat, me synimin për të organizuar pyetjet e një minikonkursi. Pyetjet duhet të jenë: 5 pyetje me përgjigje argumentuese, 5 pyetje me alternativa dhe 2 pyetje-enigmë.			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 15. <i>Përsëritje</i> . Ngjyrat e dritës		Situata e të nxëniet: Situata të përgatitura nga temat e mëparshme.	
<p>Rezultatet e të nxëniet të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të tregojnë se nga se varet nga se varet ngjyra e një trupi. 2. Të përshkruajnë eksperimentin e zërthimit të dritës së bardhë 3. Të punojnë në grup për të përzgjedhur pyetjet më të sakta. 			
Mjetet: Materiale mësimore shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja.	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë marrë për ngjyrat, por edhe me njohuritë e tyre të mëparshme, si edhe me gjuhën dhe komunikimin.</p>		
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<p>Veprimtaria 1: Diskutohet në grupe në lidhje me pyetjet që nxënësit kanë përgatitur, për të përzgjedhur pyetjet më të sakta dhe hartohet një listë me pyetjet e përzgjedhura.</p>			
<p>Praktikë e drejtuar: Mësuesi/ja organizon minikonkursin dhe orienton nxënësit të drejtojnë fillimisht 5 pyetjet me përgjigje, ku secila pyetje vlerësohet me 1 pikë, më pas 5 pyetjet me alternativa, ku secila pyetje vlerësohet gjithashtu me 1 pikë dhe në fund 2 pyetje enigma. Grupi që fiton 10 pikë është grupi fitues. Një nxënëse shkruan pikët në tabelë.</p>			
<p>Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për formulimin e saktësinë e ndërtimit të pyetjeve dhe të përgjigjeve të dhëna.</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 16. Prodhimi i tingullit			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Të identifikojnë kushtet për formimin dhe përhapjen e tingullit. 2. Të përshkruajnë shembuj të përhapjes së tingullit në mjedis 3. Të shpjegojnë pse tingulli nuk mund të përhapet në boshllëk. 			
Mjetet: tryezë, shiritit ngjites, dy vizore.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë marrë në lëndën e Edukimit Muzikor.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<p>Diskutim i njohurive paraprake: Diskutohet situata e të nxënit. Çfarë ndodh? Ata tregojnë se vizorja e gjatë vibron në mënyrë shumë më të dukshme dhe nxjerr një tingull të mbytur; vizorja e shkurtër vibron më shpejt, ndërsa tingulli që prodhon është më i mprehtë. Arrihet në përfundimin se tingujt përcaktohen nga vizorja që lëkundet.</p> <p>Lexim / përmbledhje në dyshe: Mësuesi/ja përgatit nxënësit të lexojnë tekstin. <i>Ç'loj vale është vala e tingullit?</i> Nga përmbledhja në dyshe ata nxjerrin përmbajtjen e paragrafit dhe argumentojnë se vala e tingullit është valë gjatësore, sepse grimcat e mjedisit lëkunden sipas drejtimit të përhapjes së saj. Njëpërmjet leximit ndërveprues nxënësit argumentojnë se tingulli nuk mund të përhapet në boshllëk. <i>Ku përhapet më shpejt energjia e tingullit? Pse?</i></p> <p>Punë individuale: <i>Arsyetoni, në cilin rast tingulli përhapet më shpejt, në ajër të ngrohtë apo në ajër të ftohtë?</i></p> <p>Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për përshkrimin e mënyrës si prodhohet tingulli, për përshkrimin e shembujve të përhapjes së tingullit në mjedis, si edhe për shpjegimin pse tingulli nuk mund të përhapet në boshllëk.</p> <p>Detyrë shtëpie e sugjeruar: Mund t'u jepet nxënësve si detyrë rubrika “?” në faqen 39, ku nxënësit të shpjegojnë fakte eksperimentale dhe natyrore.</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 17. Vala e zërit. Fortësia dhe lartësia e tingullit		Situata e të nxënimit: Mbështjellim një karton në formën e hinkës dhe e fiksojmë me një ngjitës shirit. Dëgjojmë një muzikë me volum të ulët. Anën e ngushtë të hinkës e afrojmë të veshi. Pastaj afrojmë anën e ngushtë të hinkës te goja.	
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Të përkufizojnë karakteristikat e valës së zërit. 2. Të përshkruajnë shembuj të përhapjes së valës zanore në mjedis. 3. Të krahasojnë fortësinë dhe lartësinë e tingullit.		Fjalët kyç: gropa, kreshta, gjatësi vale, amplitudë, frekuencë.	
Mjetet: karton, ngjitës shirit, radio, tabela e diagramit të një vale zanore në osciloskop.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë marrë në lëndën e Edukimit Muzikor.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Diskutim i njohurive paraprake: Nxënësit diskutojnë rreth situatës së të nxënimit. <i>Çfarë ndodhi?</i> Ata arrijnë në përfundimin se, kur anën e ngushtë të hinkës e afrojmë të veshi, zëri vjen më i qartë. Kur afrojmë anën e ngushtë të hinkës te goja, zëri del i përforcuar dhe mund të dëgjohej edhe nga një tjetër që ndodhet në njëfarë largësie.			
Mbajja e strukturuar e shënimeve: Mësuesi/ja paraqet tabelën e diagramit të një vale zanore në osciloskop. U shpjegon nxënësve karakteristikat e valës së zërit. Ata udhëzohen të mbajnë shënime të strukturuar në fletoren e klasës. Më pas diskutohet në lidhje me fortësinë dhe me lartësinë e tingullit dhe interpretohen grafikët në figurën 2.31.			
Punë individuale: Kërkesa: <i>Përshkruani si prodhohen tingujt te një instrument muzikor.</i> Nxënësit punojnë në mënyrë individuale për një instrument të preferuar duke treguar si veprimet për të rritur lartësinë e një note.			
Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për përkufizimin e karakteristikave të valës së zërit, për përshkrimin e shembujve të përhapjes së valës zanore në mjedis, si edhe për krahasimin e fortësinë dhe lartësinë e tingullit.			
Detyrë shtëpie e sugjeruar: Mund t'u jepet nxënësve si detyrë rubrika "?" në faqen 39, ku ata të tregojnë duke kërkuar në internet për instrumente të cilat bëjnë të mundur që veshi të dëgjojë edhe tingujt më të dobët e më të largët.			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 18. Dëgjimi i tingullit. Veshi			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Të tregojnë si perceptohet vala zanore nëpërmjet organeve të të dëgjuarit. 2. Të dallojnë tingullin nga zhurmat. 3. Të shpjegojnë raste të ndotjes akustike në mjediset të ndryshme. 			
Mjetet: tabela e skemës së ndërtimit të veshit.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë marrë në lëndën e Biologjisë dhe Edukimit Qytetar.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<p>Diskutim i njohurive paraprake: Dëgjohej disa nga komentet e nxënësve, të cilat lidhen edhe me faktin e rolit përzgjedhës të trurit në lidhje me valët zanore. Kujtohet se orën e kaluar treguam një mënyrë se si mund ta ndihmojmë veshin që të dëgjojë sa më shumë.</p> <p><i>Si vepruam?</i></p> <p>Lexim i drejtuar: Udhëzohen nxënësit të lexojnë paragrafët në libër dhe diskutohet rreth këtij sistemi të përsosur me anën e të cilit ne dëgjojmë. Paraqitet tabela e ndërtimit të veshit dhe shpjegohet mekanizmi i të dëgjuarit. Së bashku me nxënësit diskutohet se veç ndotjes së mjedisit, edhe ndotja akustike është një problem shumë i madh në ditët e sotme.</p> <p>Punë individuale: U kërkohet nxënësve të përshkruajnë nëse kanë hasur raste ta dallojnë ndotjen akustike në mjediset të ndryshme dhe cilat janë masat që merren sot për ta zvogëluar atë.</p> <p>Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për përshkrimin si perceptohet vala zanore nëpërmjet të dëgjuarit, për dallimin e tingullit nga zhurmat, si edhe për shpjegimin e rasteve të ndotjes akustike në mjediset të ndryshme.</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 19. Përsëritje. Të dëgjuarit dhe tingulli			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
<ol style="list-style-type: none"> Të krijojnë fjali të sakta fizike me fjalët e dhëna. Të tregojnë se tingujt mbërrijnë te veshi ynë falë vibrimeve në ajër. Të zbatojnë njohuritë për të shpjeguar situata reale në lidhje me ndotjen akustike. 			
Mjetet: teksti Fizika 8, fletë formati A4, vizore, lapsa me ngjyra.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë në në lëndën e Biologjisë dhe Edukimit Qytetar dhe Edukimit Muzikor.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Diskutim i njohurive paraprake: Lexohen disa prej shkrimeve të nxënësve dhe u kërkohet të formulojnë ligjet e pasqyrimin të dritës, duke bërë përmbledhjen e njohurive kryesore mbi të dëgjuarit dhe tingullin.			
Përvijim i të menduarit: Pasi mësuesi/ja bindet që njohuritë kryesore janë përvetësuar, orienton nxënësit drejt zgjidhjes së ushtrimeve 1, 2, 5, 6 të rubrikës “Pyetje” në faqen 42. Duhet të tregojnë kujdes në ushtrimin 3 për të përcaktuar mënyrat për mbrojtjen e dëgjimit. U lihët nxënësve koha e nevojshme dhe aktivizohen nxënës të niveleve të ndryshme për të dhënë përgjigjet e ushtrimeve. Diskutimet shtrihet në të gjithë klasën.			
Punë në dyshe: Në këtë fazë, nxënësit punojnë në dyshe ushtrimin 6. Ata diskutojnë me njëri-tjetrin se ku ndryshojnë figurat a) dhe b) në qoftë se do t’i dëgjonim me të vërtetë. Udhëzohen nxënësit të vizatojnë një skicë që tregon ndotjen akustike. Tregohen para nxënësve idetë në skicat më të sakta.			
Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për krijimin e fjalive të sakta fizike, për përshkrimin e mënyrës si mbërrijnë tingujt në veshin tonë falë vibrimeve në ajër, si edhe për zbatimin e njohurive për shpjegimin e situatave reale në lidhje me ndotjen akustike në jetën e përditshme.			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 20. Jehona. Përdorimi i jehonës		Situata e të nxënimit: Paraqitet me video-projektor pjesë nga filmi "Beni ecën vetë", fragmenti i jehonës.	
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyç: jehona.	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Të përkufizojnë jehonën si perceptim të valëve zanore të pasqyruar nga një pengesë. 2. Të shpjegojnë fakte eksperimentale dhe natyrore ku ndodh jehona. 3. Të llogaritnin thellësi nënujore përmes jehonës. 			
Mjetet: lap top, video projektor, sequenca të ndryshme filmike për dukurinë e jehonës.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë marrë në fëndën e Diturisë së Natyrës, Letërsisë e Historisë.		
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<p>Diskutim i njohurive paraprake: Diskutohet pjesa filmike. Pse vendosin dorën rreth gojës fëmijët kur thërrasin Benin? Kujtojmë si pasqyrohet drita nga një sipërfaqe dhe bindemi se valët e tingullit pasqyrohen në të njëjtën mënyrë si ato të dritës. Jepet përkufizimi i jehonës dhe shpjegohet ekolokacini.</p> <p>Përvijim i të menduarit: U kërkohet nxënësve të sjellin shembuj të ndryshëm të jehonës, duke kujtuar histori të ndryshme apo edhe lexime të librave. Si i përcaktojnë se ku ndodhen objektet ose si "e shohin" ushqimin lakuriqët e natës? Nxënësit diskutojnë lirshëm mendimet e tyre rreth temës së përdorimit të jehonës nga kafshë e nga specialistë të fushave të ndryshme.</p> <p>Punë individuale: Udhëzohen nxënësit të lexojnë paragrafët <i>Jehona</i> dhe <i>Përdorimi i jehonës</i>. Pasi u lihet koha e nevojshme, pyeten nëse përputhen mendimet e tyre me ato në libër. <i>Çfarë mësuam të re?</i> Diskutojmë. Punohet me nxënësit shembulli 1 në libër.</p> <p>Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për përkufizimin e jehonës, për shpjegimin e fakteve eksperimentale dhe natyrore ku ndodh jehona dhe për llogaritjen e thellësi nënujore.</p> <p>Detyrë shtëpie e sugjeruar: Mund t'u jepet nxënësve detyrë të listojnë kafshë që orientohen duke përdorur ekolokacinin.</p>			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE nr. 21

Data _____

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 21. Matja e shpejtësisë të tingullit. Ultratingujt			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Të tregojnë si mund ta matim shpejtësinë e tingullit. 2. Të gjejnë shpejtësinë e tingullit duke zbatuar formulën përkatëse. 3. Të tregojnë ç'janë ultratingujt dhe ku gjejnë përdorim ato.		Fjalët kyç: shpejtësi, tingull, ultratingull.	
Mjetet: kronometër, fletë, laps.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë në Matematikë dhe në TIK.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Hulumtojmë dhe zbulojmë: Kryejmë eksperimentin e mëposhtëm: Një nxënës qëndron 50 m përballë një ndërtese të lartë. Përplas një herë duart dhe pret derisa të dëgjojë jehonën. Sapo e dëgjon përplas përsëri duart. Një nxënës tjetër mat kohën e 10 përplasjeve. <i>Çfarë të dhënash morëm? A mundeni me këto të dhëna të gjeni shpejtësinë e tingullit?</i> Nxënësit punojnë në grupe dyshë.			
Lexim i drejtuar. Udhëzohen nxënësit të lexojnë tekstin dhe të krahasojnë rrugën e ndjekur me shembullin e dhënë ne libër. <i>Cila është njësia e shpejtësisë së tingullit?</i> Pyeten nxënësit ku përdoren ultratingujt. Si mund të gjejnë objekte që ndodhen në thellësi të detit?			
Punë në dyshe: Udhëzohen të punojnë ushtrimet 1, 2 dhe 3 në fletoren e klasës. Më pas ata këmbëjnë fletoret për të diskutuar zgjidhjet me njëri-tjetrin. Vijohet puna me ushtrimet 4, 5 dhe 6.			
Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për mënyrën si mund ta matim shpejtësinë e tingullit, për gjetjen e shpejtësinë së tingullit duke zbatuar formulën, si edhe për përdorimet e ultratingujve në fusha të ndryshme.			
Detyrë shtëpie e sugjeruar: Mund t'u jepet nxënësve detyrë të gjejnë materiale nga interneti dhe të përshkruajnë disa përdorime praktike të ultratingujve.			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE nr. 22

Data _____

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 22. Përsëritje. Pasyrimi i tingullit		Situata e të nxënësve: Paraqitni në mënyrë skematike një tingull dhe një zhurmë. Çfarë dallimi vëmë re?	
Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Të paraqesin në mënyrë skematike dallimin mes një tingulli dhe një zhurme. 2. Të identifikojnë lloje të ndryshme të tingujve. Të gjejnë shpejtësinë e tingullit. 3. Të sjellin shembuj të përdorimit të ultratingujve në jetën e përditshme.		Fjalët kyç: tingull, valë gjatësore, molekulat e ajrit, ngjeshje, rrallim, kreshta, gjatësi vale, amplitudë, frekuencë, jehona. shpejtësi, tingull, ultratingull	
Mjetet: fletë A4, laps.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë marrë në lëndën e Edukimit Muzikor dhe të Edukimit Figurativ.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<p>Diskutim i njohurive paraprake: Paraqiten disa vizatime të nxënësve dhe pyeten ku janë bazuar. Ata thonë se trupat që dridhen në mënyrë të parregullt prodhojnë zhurma. <i>Ku qëndron dallimi mes një tingulli dhe një zhurme?</i> Diskutimi zgjat rreth 3-4 minuta.</p> <p>Marrëdhënie pyetje-përgjigje. U lihet nxënësve një kohë e caktuar, në mënyrë që ata të hartojnë pyetje në lidhje me tingullin, kushtet e përhapjes së tij, gjetjen e shpejtësisë së tingullit, përshkrimi i ultratingullit dhe përdorimet e tij. Më pas aktivizohen nxënës për të bërë pyetje dhe për të dhënë përgjigje. Kjo metodë i ndihmon ata për përfundimin e njohurive të mëparshme.</p> <p>Punë individuale: Në këtë fazë nxënësit udhëzohen të krijojnë një problem për gjetjen e shpejtësisë së tingullin. Ata ia japin shokut pranë për ta zgjidhur.</p> <p>Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për paraqitjen skematike të një tingulli dhe një zhurme, për identifikimin e llojeve të ndryshme të tingujve, për gjetjen e shpejtësisë së tingullit, si edhe për shembuj të përdorimit të ultratingujve në jetën e përditshme.</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<p>Tema mësimore 23. Detyra. Jehona (Detyrë për vlerësim portofoli)</p>			
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>1. Të përshkruajnë një situatë ku të evidentohet jehona. 2. Të identifikojnë faktorët më të rëndësishëm në situatë. 3. Të argumentojnë përgjigjet e dhëna.</p>		<p>Fjalët kyç: jehonë, shpejtësi e tingullit.</p>	
<p>Mjetet: Fletë Pune 2.11, fletë A4.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë në lëndën e Biologjisë, të Diturisë së Natyrës dhe të Letërsisë.</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>			
<p>Gjatë kësaj orë mësimore nxënësit do të punojnë në mënyrë individuale dy veprimtaritë e mëposhtme.</p>			
<p>Veprimtari 1: Nxënësit shkruajnë në fletore fjalët: <i>delfin, lakuriq nate, jehonë e tingullit, shpejtësi e tingullit, ultratingujt, jehona, dëgjoji, ushqim, humnerë</i>. Mësuesi/ja fton nxënësit që, duke përdorur fjalët e dhëna, të krijojnë një ese dhe t'i vendosin asaj një titull.</p>			
<p>Veprimtari 2: Nxënësit u japin përgjigje pyetjeve në Fletë Pune 2.11.</p>			
<p>Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për përshkrimin e një situatë ku evidentohet jehona, për identifikimin e faktorëve më të rëndësishëm në një situatë, si edhe për argumentimin e përgjigjeve të dhëna.</p>			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE nr. 24

Data _____

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 24. Veprimtari praktike. Krijimi i melodeve muzikore			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Të tregojnë ç'është një shkallë muzikore dhe notat e saj. 2. Të tregojnë si prodhohen tinguj muzikorë. 3. Të punojnë në grup për të nxjerrë përfundime. 			
Mjetet: Fletë Pune 2.10, pesë provëza laboratorike të njëjta, mbajtëse provëzash, ujë, vizore, stilolaps shënues, pipetë.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë marrë në lëndën e Edukimit Muzikor si dhe me fushën e gjuhës dhe të komunikimit.		
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Diskutim i njohurive paraprake: Ndahet klasa në grupe me nga pesë vetë. Secili nxënës ka rolin e tij brenda grupit. U kujtohet nxënësve që lartësia e notës së një instrumenti muzikor varet nga përmasat e hapësirës që lëkundet. Kujtohen nxënësit të zbatojnë udhëzimet e sigurisë.			
Praktikë e drejtuar: Ndiqen udhëzimet e Fletës së Punës 2.10. Monitorohet puna e nxënësve brenda grupeve dhe udhëzohen ata t'i renditin provëzat sipas lartësisë së kolonës së ajrit. Një nxënës bën tabelën e rezultateve dhe të gjitha matjet i shënon atje. Udhëzohen nxënësit të shikojnë rezultatet dhe të nxjerrin përfundimet.			
Punë në grup: Në përfundim të veprimtarisë praktike kryetari i grupit referon në lidhje me punën e bërë dhe për rolin që ka luajtur secili anëtar i grupit. Ata pyetën sa të vështirë e patën “sinkronizimin” e provëzave.			
Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për punën në grup dhe për krijimin e melodeve muzikore.			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<p>Tema mësimore 25. Përdorimi dhe rreziqet që vijnë nga drita dhe tingulli</p>			
<p>Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të tregojnë si përhapet ultratingulli në ujë. 2. Të interpretojnë figurat e dhëna. 3. Të tregojnë nëse drita dhe tingulli paraqesin rreziqe. 			
<p>Mjetet: Tabelat javë printuar më parë në A4</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë në lëndën e Historisë.</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>			
<p>Lexim i drejtuar. Diskutohet situata e të nxënimit dhe në vijim udhëzohen nxënësit të lexojnë tekstin.</p>			
<p>Punë individuale: Në ajër zëri përhapet me shpejtësi 340 m/s, kurse në ujin e oqeanit me shpejtësi 340 m/s. Ndahen nxënësit në tre grupe dhe secili grup interpreton njëren nga figurat. Nxënësit duhet të përdorin jo më shumë se 6-7 fjali.</p>			
<p>Pyetje për diskutim: Nxënësit tregojnë situata nga jeta e përditshme kur kanë vënë re ndotjet akustike, si në rastin e ndërtimeve të rruigëve apo ndërtesave, boritë e makinave, muzika e lartë në dasma a ditëlindje etj. Nxitini ata me pyetje, si: <i>A kemi ndotje akustike në shkollë? Po në shtëpi? Po në aeroporte? Çfarë masash duhet të marrim për të zvogëluar atë?</i></p> <p>Vlerësimi: Në përfundim të mesimit nxënësit vlerësohen për përshkrimin e përhapjes së tingullit në ujë dhe interpretimin e figurave të dhëna.</p> <p>Detyrë shtëpie e sugjeruar: Mund t'u jepet nxënësve detyrë të tregojnë pse delphinët mund të “dëgjojnë” dhe të “flasin” me njëri tjetrin dhe kuriozitetet.</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 26. Përsëritje. Drita dhe tingulli			
<p>Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të tregojnë se ku ndryshon një valë tërthore nga një valë gjatësore. 2. Të shpjegojnë si formohen hijet dhe gjysmëhijet. 3. Të përshkruajnë pasqyrimin dhe përthyerjen e dritës. 4. Të shpjegojnë si i shohim objektet e ndriçuara dhe jo të ndriçuara. 5. Të llogaritin shpejtësinë e përhapjes së tingullit. 6. Të shpjegojnë pse tingulli përhapet me shpejtësi të ndryshme në materiale të ndryshme. 			
<p>Mjetet: materiale mësimore shtesë të përgatitura nga mësuesi/ja dhe nxënësit si tabela, foto të ndryshme në A4 etj.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë që nxënësit kanë marrë për dritën dhe tingullin, si edhe me gjuhën e komunikimin.</p>	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<p>Veprimtaria 1: Diskutohet në grupe në lidhje me pyetjet që nxënësit kanë përgatitur, për të përzgjedhur pyetjet më të sakta dhe hartohet një listë me pyetjet e përzgjedhura. Ato kategorizohen në: 1. PP, 2. PA, 3. PE.</p>			
<p>Praktikë e drejtuar: Mësuesi/ja organizon minikonkursin dhe orienton nxënësit të drejtojnë fillimisht 5 pyetjet me përgjigje, ku secila pyetje vlerësohet me 1 pikë, më pas 5 pyetjet me alternativa, ku secila pyetje vlerësohet gjithashtu me 1 pikë dhe në fund 2 pyetje enigme. Grupi që fiton 10 pikë është grupi fitues. Një nxënës shkruan pikët në tabelë.</p>			
<p>Vlerësimi: Në përfundim të mesimit nxënësit vlerësohen për saktësinë e pyetjeve dhe të përgjigjeve të dhëna.</p>			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE nr. 27

Data _____

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 27. Test i tremujorit të dytë (Janar-Mars)		Situata e të nxënit:	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Të përshkruajnë marrëdhëniet midis këndeve të rënies dhe të reflektimit. 2. Të njehsojnë largësinë e një objekti, duke përdorur njësinë e kohës që i duhet tingullit të pasqyrohet. 3. Të shpjegojnë si ndryshon kalimi i dritës nëpërmjet një materiali, në varësi të vlerës së treguesit të përthyerjes së tij.		Fjalët kyç: kënd i rënies dhe i reflektimit, largësi e një objekti, koha që i duhet tingullit të pasqyrohet, tregues i përthyerjes etj.	
Mjetet: testet përgatiten në fletë formati A4.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Ky test formulohet në bazë të njohurive të fituara nga nxënësit gjatë tremujorit të parë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënëseve			
Një model testi ndodhet në rubrikën "Shtojcë".			
Koha e zhvillimit 45 minuta.			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 28. Vlerësim i portofolit të nxënësit			
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyç: panair, portofol.	
1. Të përshkruajnë shkurtimisht përmbajtjen e portofolit.			
2. Të evidentojnë punimet më të realizuara.			
3. Të vlerësojnë rëndësinë e plotësimit të portofolit.			
Mjetet: detyrat e punuara në klasë, në shtëpi, projektet dhe materiale të tjera.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo orë mësimi lidhet me njohuritë e nxënësve me Artin Pamor, TIK, si dhe me gjuhën dhe komunikimin.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<p>Secili nxënës vrojton portofolin e nxënësit me të cilin qëndron në bankë. Ata mbajnë shënime për punimet më të mira dhe ato që duhen përmirësuar, duke përdorur një shkallë vlerësimi nga 1-3. Nxënësit shohin dhe vlerësojnë rregullsinë e dosjes, organizimin e punimeve, punimet individuale, detyrat e shtëpisë e të klasës, testet, si edhe vlerësimet e mësueses. Nxënësit, të cilët kanë mangësi të detyrave ose detyra për të përmirësuar mund t'i plotësojnë ato në shtëpi. Në fund, mësuesi/ja bën një vlerësim të portofolave më të mirë të klasës dhe të portofolave të tjerë.</p> <p>Diskutohet me nxënësit rreth detyrave që i kanë realizuar me më shumë dëshirë dhe çfarë do të donin të përmirësonin gjatë periudhës në vazhdim.</p>			

**III. PLANIFIKIMI I ORËVE MËSIMORE
TË TREMUJORIT TË TRETË
PRILL-QERSHOR**

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE nr. 1

Data _____

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 1. Drita e padukshme		Situata e të nxënësve: Në verë, në një ditë me diell, lëkura nxihet më shumë në mal se sa në fushë. Pse ndodh kjo?	
Rezultatet e të nxënësve sipas temës mësimore: 1. Të tregojnë cilët trupa lëshojnë rreze infra të kuqe. 2. Të tregojnë si mund ta dallojmë praninë e rrezeve infra të kuqe. 3. Të tregojnë vendosjen e rrezeve që njohin në spektrin elektromagnetik.		Fjalët kyç: rreze infra të kuqe, spektri elektromagnetik.	
Mjetet: llambë, copë hekuri, karton me përmasa 50x50 cm, termometër.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë e nxënësve nga lënda e Matematikës dhe e Gjeografisë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<p>Hulumtojmë dhe zbulojmë: Në flakën e llambës ngrohim derisa të skuqet copën e hekurit. Vendosim afër copës së hekurit një karton me përmasa 50x50 cm, të cilit i kemi hapur një çarje, dhe mbrapa kartonit të kjo çarje vendosim një termometër. Lexojmë tregimet e termometrit në raste të ndryshme; kur çarja është e hapur dhe kur është e mbyllur. Termometri tregon temperaturë më të lartë kur çarja është e hapur, në krahasim me rastin kur ajo është e mbyllur, kurse në pozicione të ndryshme, tregimet e tij nuk ndryshojnë. Pra, bindemi se trupat e nxehtë lëshojnë rreze që shkaktojnë ngrohje, të cilat quhen <i>rreze infra të kuqe</i>. P.sh., soba e ndezur dhe motori i një automjeti, dielli etj. lëshojnë rreze infra të kuqe.</p>			
<p>Udhëzuesi i të lexuarit ndërveprues: Udhëzohen nxënësit të lexojnë paragrafin në libër. Pas disa minutash, mësuesi/ja fton nxënësit të tregojnë ngjyrat që përfshin spektri elektromagnetik dhe i nxit ata ta vizatojnë në fletore. Nxënësit tregojnë ç’është laseri dhe ku ndryshon nga drita e bardhë.</p>			
<p>Rishikim në dyshe: Diskutoni në dyshe: Në një ditë të nxehtë korriku, Albani qëndroi shumë në diell dhe në darkë ai ankohej nga se i dhembte lëkura. Pse? Si mund ta formulojmë bukur përgjigjen?</p>			
<p>Vlerësimi: Në fund të mësimit nxënësit vlerësohen për nxjerrjen e përfundimeve të eksperimentit, si edhe për plotësimin e spektrit elektromagnetik.</p>			
<p>Detyrë shtëpie e sugjeruar: Nxënësi ndahen në dy grupe: Grupi A) Pse mjeku këshillon fëmijët e vegjël të nxirren në diell? Grupi B) Pas punës, minatorët futen në mjedis me llamba të posaçme që prodhojnë rreze ultravjollcë. Pse?</p>			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE nr. 2

Data _____

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 2. Komunikimi			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyç: rreze infra të kuqe, valët e radios.	
1. Të tregojnë se valët e radios përdoren për transmetime të ndryshme.			
2. Të japin shembuj të trupave që lëshojnë rreze infra të kuqe.			
3. Të argumentojnë nëse është i rrezikshëm përdorimi i telefonave celularë.			
Mjetet: radio, mikrofon.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë e nxënësve nga lënda e Biologjisë.		
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Diskutim për njohuritë paraprake: Diskutohet në lidhje me situatën e të nxënit dhe tregohet se valët radioelektrike janë rreze të padukshme.			
Udhëzuesi i të lexuarit ndërvetprues: Udhëzohen nxënësit të lexojnë paragrafin në libër. Pas disa minutash, mësuesi/ja fton nxënësit të tregojnë se si komunikohet më parë dhe si kanë ndryshuar mjetet e komunikimit. Ata diskutojnë për njohuritë fizike që përdoren kompanitë e ndryshme që prodhojnë mjete komunikimi dhe për përdorimin e telefonave celularë. Mësuesi/ja i nxit ata me pyetje, si: <i>Si funksionon mikrofooni dhe si del zëri i përforcuar prej tij?</i>			
Rishikim në dyshe: Nxënësit diskutojnë rreth pyetjes: <i>A është i rrezikshëm përdorimi i telefonave celularë?</i>			
Vlerësimi: Në fund të mësimit nxënësit vlerësohen për ilustrimin me shembuj të trupave që lëshojnë rreze infra të kuqe, për argumentet e tyre në lidhje me rrezikshmërinë e përdorimit të telefonave celularë.			
Detyrë shtëpie e sugjeruar: Përshkruani në formën e një eseje si do të ishte jeta juaj pa internet? Vendosini një titull.			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<p>Tema mësimore 3. Gatimi. Përdorimi i rrezeve ultravjollcë</p>			
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>1. Të japin shembuj të trupave që lëshojnë rreze ultravjollcë.</p> <p>2. Të tregojnë lidhjen midis frekuencës së valëve elektromagnetike dhe të energjisë që mbartin ato.</p> <p>3. Të sjellin informacione mbi përdorimin e rrezeve ultravjollcë.</p>			
<p>Mjetet: tabela mësimore</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë e nxënësve nga lënda e Biologjisë.</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>			
<p>Diskutim për njohuritë paraprake: Lexohen disa prej detyrave të shtëpisë. Pyeten nxënësit pse rrezet infra të kuqe i quajmë “rrezatim i nxehtësisë”.</p>			
<p>Udhëzuesi i të lexuarit ndërveprues: Udhëzohen nxënësit të lexojnë paragrafin në libër. Pas disa minutash, mësuesi/ja fton nxënësit të tregojnë ç’janë rrezet dhe ku gjejnë përdorim rrezet ultravjollcë. Theksohet se rrezet ultravjollcë ngordhin bakteret dhe gjithashtu ndihmojnë në kryerjen e mjaft proceseve në organizmin e njeriut. Tregohet lidhja midis frekuencës së valëve elektromagnetike dhe energjisë që mbartin ato.</p>			
<p>Rishikim në dyshe: Tregoni disa kaste kur rrezet ultravjollcë janë të dëmshme ose të dobishme.</p>			
<p>Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për shembuj të trupave që lëshojnë rreze ultravjollcë, si edhe për lidhjen midis frekuencës së valëve elektromagnetike dhe të energjisë që mbartin ato.</p>			
<p>Detyrë shtëpie e sugjeruar: Materiale shtesë nga interneti apo nga revista shkencore për përdorimin praktik e të specializuar të rrezeve ultravjollcë.</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<p>Tema mësimore 4. Përdorimi i rrezeve në mjekësi</p>			
<p>Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të tregojnë për çfarë përdoren rrezet X. 2. Të tregojnë se cilat janë valët elektromagnetike me frekuencë më të lartë. 3. Të tregojnë ku përdoren rrezet <i>gamma</i>. 		<p>Fjalët kyç: rreze X, rreze <i>gamma</i>, mjekësi.</p>	
<p>Mjetet: pamje të skanimit të një objekti me rreze X.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë e nxënësve nga fusha e mjekësisë.</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>			
<p>Diskutim për njohuritë paraprake: Diskutohet situata e të nxënimit. Në vijim nxënësit pyeten: <i>A përbën rrezik ekspozimi në nivele të larta të këtyre rrezeve? Pse?</i></p>			
<p>Udhëzuesi i të lexuarit ndërveprues: Udhëzohen nxënësit të lexojnë paragrafin në libër. Pas disa minutash, mësuesi/ja fton nxënësit të tregojnë si duhet të mbrohem nga rreziku që paraqesin ato. Ata diskutojnë se ç'janë rrezet <i>gamma</i> dhe ku ndryshojnë nga rrezet X, nga përbërja dhe përdorimi.</p>			
<p>Rishikim në dyshe: Nxënësit punojnë në dyshe ushtrimet 1. 2 dhe 3 në fund të mësimit. Më pas ato diskutohen me të gjithë klasën.</p>			
<p>Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për shembujt e dhënë për përdorimin e rrezeve X në fusha të ndryshme, për evidentimin e valëve elektromagnetikë me frekuencë të lartë, si edhe për përdorimin e rrezeve <i>gamma</i>.</p>			
<p>Detyrë shtëpie e sugjeruar: Si detyrë mund t'u jepet nxënësve ushtrimi 4.</p>			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE nr. 5

Data _____

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 5. Vrojtimi i qiellit. Zbatime në astronomi		Situata e të nxënësve: Paraqiten pamje të sistemit diellor, të Tokës dhe planetëve të tjerë.	
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>1. Të tregojnë ç'është teleskopi dhe çfarë zbuloi Galileoja.</p> <p>2. Të përshkruajnë se si punon teleskopi me pasqyra në modelin e Njutonit.</p> <p>3. Të tregojnë zbatime të ndryshme në astronomi.</p>		<p>Fjalët kyç: teleskop, astronomi, sistem diellor.</p>	
<p>Mjetet: foto të ndryshme të planetëve, lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë e lap top, projektor.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë e nxënësve nga Fizika e klasës së shtatë, nga lënda e Gjeografisë, si edhe nga fusha e astronomisë.</p>	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
<p>Diskutim për njohuritë paraprake: Paraqiten në projektor foto të ndryshme të planetëve ose video të sistemit diellor dhe diskutohet rreth tyre.</p>			
<p>Udhëzuesi i të lexuarit ndërveprues: Nxënësit lexojnë për disa minuta mësimin. Ndahen nxënësit në dy grupe dhe secili grup i jep përgjigje:</p> <ul style="list-style-type: none"> - grupi A) pyetjeve rreth skicave të Galileos, - grupi B) pyetjeve për modelin e Njutonit. 			
<p>Rishikim në dyshe: Udhëzohen nxënësit të vizatojnë figurën 2.45 dhe të përshkruajnë se si punon teleskopi me pasqyra.</p>			
<p>Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për përshkrimin e teleskopit me pasqyra dhe zbatimet e ndryshme të tij në astronomi.</p>			
<p>Detyrë shtëpie e sugjeruar: Mund të jepet rubrika “?” dhe t’u kërkohet nxënësve t’i argumentojnë përgjigjet e tyre. Ata mund të kërkojnë kuriozitete për teleskopin hapësinor <i>Habll</i>.</p>			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE nr. 6



Data _____

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<p>Tema mësimore 6. Radioastronomia. Astronomia e rrezeve X dhe <i>gamma</i>.</p>			
<p>Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> Të tregojnë kushtin që një detektor i rrezatimit elektromagnetik të funksionojë sa më mirë. Të tregojnë si mund të përdorë astronomia një pjesë të spektrit elektromagnetik. Të dallojnë teleskopët e montuar në satelit nga ata që janë montuar të tokë. 			
<p>Mjetet: foto të ndryshme të hapësirës, lap top, projektor.</p>		<p>Fjalët kyç: detektor i rrezatimit elektromagnetik, teleskop.</p>	
<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë e nxënësve nga fusha e astronomisë dhe nga lënda e Gjeografisë.</p>			
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>			
<p>Diskutim për njohuritë paraprake: Paraqiten në projektor foto të ndryshme të hapësirës dhe diskutohet rreth tyre. Më pas pyeten nxënësit të japin mendime rreth njohurive mbi radioastronominë dhe astronominë e rrezeve X dhe <i>gamma</i>, si edhe për vrimat e zeza.</p>			
<p>Udhëzuesi i të lexuarit ndërveprues: Nxënësit lexojnë tekstin dhe tregojnë kushtin që një detektor i rrezatimit elektromagnetik të funksionojë sa më mirë. Më pas ata krahasojnë përgjigjet e tyre me ato të dhëna në libër.</p>			
<p>Rishikim në dyshe: Nxënësit u japin përgjigje me shkrim pyetjeve 1, 2 dhe 3 të librit në fletoren e klasës. Më pas diskutimet zhvillohen me të gjithë klasën dhe aktivizohen nxënës të niveleve të ndryshme.</p>			
<p>Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për dallimin e kushtit që një detektor i rrezatimit elektromagnetik të funksionojë sa më mirë dhe për dallimin e teleskopëve të montuar në satelit nga ata të montuar të tokë.</p>			
<p>Detyrë shtëpie e sugjeruar: Kërkoni informacione shtesë dhe kuriozitete në lidhje me radioastronominë dhe astronominë e rrezeve X dhe <i>gamma</i>.</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 7. Detyra. Imazheria mjekësore		Situata e të nxënit: Ju ndodh që gjatë një loje futbolli të ndieni dhimbje në gju. Doktori ju thotë se mund të keni dëmtuar ligamentet e gjurit. Çfarë iu rekomandon ai?	
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të tregojnë ç'është imazheria mjekësore. 2. Të identifikojnë teknikat e ndryshme të imazherisë mjekësore. 3. Të krahasojnë përparësitë dhe mangësitë e secilës prej tyre. 		<p>Fjalët kyç: imazheri mjekësore, teknika të imazherisë.</p>	
Mjetet: fletë punë 2.12	<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë e nxënësve nga lënda e Matematikës dhe e Gjeografisë.</p> <p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>		
<p>Diskutim për njohuritë paraprake: Diskutohet situata e të nxënit dhe tregohet se me anë të grafisë mund të vëzhgohet brenda trupit, pa qenë nevoja për të ndërhyrje kirurgjikale. <i>A njihni teknika të tjera të imazherisë mjekësore?</i></p>			
<p>Udhëzuesi i të lexuarit ndërveprues: Udhëzohen nxënësit të lexojnë paragrafin në Fletën e Punës 2.12 Pas disa minutash, mësuesi/ja fton nxënësit të tregojnë ç'është imazheria mjekësore dhe cilat janë teknikat e ndryshme të saj, si dhe ç'njohuri fizike shfrytëzohen për funksionimin e aparatave mjekësore. Diskutohet për raste të jetës së përditshme.</p>			
<p>Rishikim në dyshe: U japin përgjigje pyetjeve 1 dhe 2 të Fletës së Punës. Nxënësve u kërkohet të argumentojnë pse vendosën pikërisht atë teknikë. Ngrihen pyetje, si: <i>Çfarë përdorin radiologët? A paraqet rrezikshmëri për shëndetin përdorimi i metodave të imazherisë mjekësore? Cilat janë përparësitë e saj? Po mangësitë? Dini raste që i vërtetojnë këto?</i></p>			
<p>Vlerësimi Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për përkufizimin e imazherisë mjekësore, për identifikimin e teknikave të ndryshme të saj, si edhe për krahasimin e përparësive dhe të mangësive e secilës prej tyre.</p>			
<p>Detyrë shtëpie e sugjeruar: Pyesni prindërit t'ju tregojnë për raste që njohin të përdorimit të imazherisë mjekësore.</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 8. Pyetje dhe problema			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:		Fjalët kyç: shpejtësi mesatare, largësi, kohë, nxitim, njësi.	
1. Të llogarit kohën që i duhet dritës për të përshkruar një rrugë të caktuar.			
2. Të shpjegojnë dukuri që lidhen me dritën dhe tingullin.			
3. Të argumentojnë zgjidhjet e situatave të dhëna.			
Mjetet: teksti Fizika 8 faqe 53, 54, 55, laps, vizore, fletë formati A4.	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë e nxënësve në Matematikë dhe në temat e zhvilluara të Fizikës 8.		
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Diskutim për njohuritë paraprahe: Nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin në lidhje me situatën e të nxënit dhe të shpjegojnë pse ndodh. Mësuasi/ja u kërkon nxënësve të sjellin shembuj të tjerë ngjashëm. Kujtojmë: Si ndodh eklipsi i diellit? Po i hënës? Mund të ndërtohet një hartë koncepti me konceptet kryesore teorike të kapitullit mbi dritën dhe tingullin.			
Praktikë e zbatuar: U shpërndahen nxënësve fletë formati A4 dhe udhëzohen të zgjidhin ushtrimet në faqen 53 dhe 54 të librit. Ata ndahen në dy grupe dhe punojnë në mënyrë të pavarur; grupi A punon ushtrimet me numër tek dhe grupi B ushtrimet me numër çift. U risillet në vëmendje se duhet të shkruajnë përgjigje të plota dhe të sakta, duke i argumentuar ato. Monitorohet puna e nxënësve për rreth 30 minuta dhe më pas aktivizohen nxënës në tabelë për të paraqitur zgjidhjet e tyre. Nxënësit sipas grupit mund të ndërhyjnë, në rast se shoku i tyre gabon.			
Përforcim: Inkurajohen nxënësit të marrin pjesë në paraqitjen e zgjidhjeve dhe të jenë të vëmendshëm për të bërë korrigjime të përgjigjeve të shokëve të grupit.			
Vlerësimi Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për llogaritjen e kohës që i duhet dritës për të përshkruar një rrugë të caktuar shpjegimin e dukurive që lidhen me dritën dhe tingullin, si edhe për argumentimin e zgjidhjeve të situatave të dhëna.			
Detyrë shtëpie e sugjeruar: Vjohet puna në shtëpi me ushtrimet 21 dhe 22 në faqen 55 të librit.			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<p>Tema mësimore 9. Si kthehet hekuri në magnet? Çmagnetizimi i magneteve. Fusha magnetike</p>			
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> Të listojnë karakteristikat e magneteve. Të tregojnë ç'janë domenet. Të tregojnë si mund të çmagnetizohet një magnet. 			
<p>Mjetet: magnet, orë, hekur, dy gjilpëra.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë e nxënësve nga lënda e Diturisë së Natyrës.</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>			
<p>Diskutim për njohuritë paraprake: Rikujtohen njohuritë për magnetet, duke u drejtuar nxënëve pyetje, si: <i>Sa pole ka magneti? Si emërtohen ato? Si bashkëveprojnë? Sa pole formon magneti i thyer përgjysmë?</i> Diskutohet situata e të nxënësve dhe tregohet se një objekt hekuri ose çeliku mund të magnetizohet duke e fërkuar me njërin nga skajet e magnetit. Eksperimenti demonstron nga një nxënës, i cili fërkon çdonjërin nga dy gjilpërat 40 herë me radhë në të njëjtin drejtim dhe, kur i afrohen, vë re sa ato tërhiqen ose shtyhen sipas skajit që afrohet.</p>			
<p>Marrëdhëniet pyetje-përgjigje: Udhëzohen nxënësit të lexojnë tekstin dhe të shënojnë në fletoren e klasës: D - për njohuritë që i dinë; R - për njohuritë e reja; ? - për njohuritë që nuk i kanë të qarta. Pyetjet që u drejtohen nxënësve kanë të bëjnë kryesisht me njohuritë e reja: <i>Çfarë quhet dipol? Po domenet, ç'janë? Si janë orientuar dimenet në një copë hekuri të pamagnetizuar? Po kur hekuri vendoset në një fushë magnetike? Si mund të çmagnetizohet një magnet?</i></p>			
<p>Rishikim në dyshe: Nxënësit bëjnë në dyshe përmbledhjen e mësimit, duke i paraqitur në hartë konceptesh.</p>			
<p>Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për renditjen e karakteristikave të magneteve, për përshkrimin ç'janë domenet, si edhe për mënyrën se si mund të çmagnetizohet një magnet.</p>			
<p>Detyrë shtëpie e sugjeruar: Kryeni një eksperiment të thjeshtë që provon se kur magnetet marrin goditje, mund edhe të çmagnetizohen.</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<p>Tema mësimore 10. Fusha magnetike e Tokës</p>		<p>Situata e të nxënit: Kur shpërndajmë pluhurin e hekurit mbi kartonin e vendosur mbi magnet, pjesa më e madhe e pluhurit përqendrohet te skajet e dy magnetëve, ndërsa një sasi e vogël gjendet rreth pjesëve të tjera. Ç'tregon kjo?</p>	
<p>Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të përkufizojnë fushën magnetike. 2. Të identifikojnë fushën magnetike në lëndë nëpërmjet përshkueshmërisë magnetike. 3. Të shpjegojnë fushën magnetike të Tokës. 		<p>Fjalët kyç: fushë magnetike, fushë magnetike e Tokës.</p>	
<p>Mjetet: disa fletë plastike me ngjyra, kapëse letrash një magnet, akuarium, tabela mësimore.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë e nxënësve nga Dituria e Natyrës.</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>			
<p>Të mësojnë përmes lojës: Marrim disa fletë plastike me ngjyra dhe presim disa figura peshqish. Te buzët e çdo peshku vendosim kapëse letrash. Fiksojmë një magnet në një fije peri, mbushim me ujë akuariumin me peshq. Afrojmë magnetin, por pa i prekur peshqit. Çfarë ndodh?</p>			
 <p>A)</p>		 <p>B)</p>	
<p>Diskutim i përbashkët: Mësuesi/ja u drejton pyetjet nxënësve: <i>Si mund ta vëmë re praninë e fushës magnetike? A e shohim atë me sy? Si e vëmë re se ajo ekziston? Nxënësit sjellin shembuj që provojnë ekzistencën e fushës magnetike. Diskutojnë figurat A) dhe B).</i></p>			
<p>Lexim i drejtuar: <i>A sillet Toka si magnet? Nxënësit sjellin shembuj që provojnë këtë fakt dhe më pas ata pyeten edhe për busullën.</i></p>			
<p>Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për përkufizimin e fushës magnetike dhe për shpjegimin e fushën magnetike të Tokës.</p>			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE nr. 11

Data _____

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 11. Përsëritje. Magnetizmi		Situata e të nxënit: Për të ndarë mbeturinat prej hekuri e çeliku prej metaleve të tjera, shfrytëzohet fuqia ngritëse e magneteve të mëdhenj. Këto materiale më pas riciklohen.	
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Të tregojnë objekte ku përdoren magnete. 2. Të tregojnë se si përcaktohen poetet e një magneti. 3. Të shpjegojnë pse gjilpëra e busullës tregon gjithnjë veriuun.		Fjalët kyç: magnete, pole të një magneti, gjilpërë e busullës.	
Mjetet: tabela mësimore, magnete.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë e nxënësve nga lënda e Matematikës dhe e Gjeografisë.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Diskutim për njohuritë paraprake: Diskutohen njohuritë e marra për magnetet dhe për magnetizmin. U tregohet nxënësve se çeliku përdoret për të bërë magnete të përhershme, kurse hekuri përdoret për të bërë magnete të përkohshme.			
Punë individuale. Nxënësit ndahen në dy grupe: - grupi A) punon ushtrimet 1, 3, 5; - grupi B) punon ushtrimet 2, 4, 6. Pasi u lihet koha e nevojshme, ushtrimet diskutohen me të gjithë klasën.			
Vlerësimi Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për përcaktimin e poleve të një magneti, për renditjen e objekteve ku përdoren magnetet, si edhe për shpjegimin pse gjilpëra e busullës tregon gjithnjë veriuun.			
Detyrë shtëpie e sugjeruar: Mund t'u jepet ushtrimi 7 dhe ushtrime plotësuese nga Fletorja e Punës.			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<p>Tema mësimore 12. Fusha magnetike rreth një përcuesi drejtvizor</p>			
<p>Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> Të ndërtojnë një elektromagnet të thjeshtë. Të njohin rregullën e dorës së djathtë drejtimin e fushës magnetike. Të tregohet si veprohet për të prodhuar një magnet të përhershëm. 			
<p>Mjetet: tallash hekuri, gjilpëra magnetike.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë e nxënësve nga lënda e Diturisë së Natyrës dhe Aftësimit Teknologjik.</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>			
<p>Diskutim për njohuritë paraprake: Tregohen pjesët përbërëse të elektromagnetit dhe si funksionon ai. Nxënësit tregojnë se elektromagneti është një trup që përfton aftësi magnetike nga kalimi në të i rrymës elektrike.</p>			
<p>Udhëzuesi i të lexuarit ndërveprues: Udhëzohen nxënësit të lexojnë tekstin dhe të shënojnë në fletoren e klasës veçoritë e elektromagnetit. Më pas ata u përgjigjen pyetjeve, si: <i>Nga varet drejtimi i fushës? Si formulohet rregulla e dorës së djathtë? Çfarë ndodh nëse një gozhdë e fusim brenda një bobine elektrike?</i></p>			
<p>Rishikim në dyshe: Në fletoren e klasës nxënësit shkruajnë njohuritë kryesore të mësimin në një skemë.</p>			
<p>Vlerësimi: Në përfundim të mësimin nxënësit vlerësohen për ndërtimin e një elektromagneti të thjeshtë, për formulimin e rregullës së dorës së djathtë për përcaktimin e drejtimin të fushës magnetike.</p>			
<p>Detyrë shtëpie e sugjeruar: Informacione rreth shpikjes së telegrafit me të cilën lidhet historia e komunikimit në largësi.</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<p>Tema mësimore 13. Ku përdoren elektromagnetet? Releja dhe çelësi magnetik</p>		<p>Situata e të nxënësve: Eksperimentet tregojnë se fusha magnetike e një bobine rritet shumë kur brenda saj futim një shufër hekuri. Pra, fusha magnetike e krijuar nga një bobinë është më e fuqishme se ajo e krijuar nga një spirë e vetme.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të listojnë pajisje ku përdoren elektromagnetet. 2. Të përshkruajnë sistemin rele që përdoret për ndezjen e makinës. 3. Të argumentojnë se releja është një çelës magnetik. 		<p>Fjalët kyç: elektromagnet, sistemi rele, çelësi magnetik.</p>	
<p>Mjetet: tabela mësimore, bobinë, shufër hekuri, tela përcjellës, çelës etj.</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë e nxënësve nga fusha e teknikës.</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>			
<p>Diskutim për njohuritë paraprake: Lexohen disa nga detyrat e shtëpisë. Evidentohen punimet më të mira të nxënësve dhe vendosen në dosje. <i>Kush e shpiku telegrafin?</i> (Samuel Morsi në vitin 1837). <i>Te çfarë bazohet parimi i tij?</i> (Te elektromagnetizmin.) <i>Morsi krijoi një alfabet të përbërë nga pika dhe viza, i cili bën të mundur përcjelljen dhe leximin e çdo mesazhi. Ku përdoren elektromagnetet?</i> (Te zilia elektrike, te vinçat për ndarjen e lëndëve ferromagnetike etj.)</p>			
<p>Udhëzuesi i të lexuarit ndërveprues: Udhëzohen nxënësit të lexojnë tekstin dhe më pas ata përshkruajnë sistemin rele që përdoret për ndezjen e makinës. Evidentojnë raste të tjera të përdorimit të elektromagnetëve. U drejtohet pyetja: <i>A është releja çelës magnetik?</i> Nxënësve u kërkohet të argumentojnë përgjigjet e tyre.</p>			
<p>Rishikim në dyshe: Nxënësit shkruajnë njohuritë kryesore të mësimin në fletoren e klasës dhe punojnë ushtrimin 4 në faqen 72 të Fletës së Punës.</p>			
<p>Vlerësimi: Në përfundim të mësimin nxënësit vlerësohen për dhënien e shembujve të pajisjeve ku përdoren elektromagnetet, për përshkrimin e sistemit rele që përdoret për ndezjen e makinës, për argumentimin se releja është një çelës magnetik.</p>			
<p>Detyrë shtëpie e sugjeruar: Tregoni si funksionon releja që vendoset në çelësat e dyerve për të dhënë alarmin në rast vjedhjeje.</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<p>Tema mësimore 14. Veprimtari praktike. Fusha magnetike e magnetit shufër</p>		<p>Situata e të nxënimit: Paraqiten në projektor pamje të fushës magnetike.</p>	
<p>Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p> <p>1. Të parashikojnë çfarë do të ndodhë me modelin e fushës magnetike, nëse rritet rryma në përçues.</p> <p>2. Të punojnë në grup për të kryer matje dhe për të nxjerrë përfundime.</p> <p>3. Të zbatojnë rregullën e dorës së djathtë për fushën elektromagnetike.</p>		<p>Fjalët kyç: fushë magnetike, përçues, rregulla e dorës së djathtë.</p>	
<p>Mjetet: Fletë Pune 3.3, burim rryme e vazhduar dhe alternative me tension të ulët 2V, tel bakri, gjilpërë magnetike, fletë kartoni me përmasat e një kartolinë, tallash hekuri, lap top, projektor</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë e nxënësve mbi elektricitetin dhe magnetizimin të marra në lëndën e Diturisë së Natyrës.</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>			
<p>Diskutim për njohuritë paraprake: Diskutohet në lidhje me njohuritë kryesore dhe më pas nxënësit ndahen në grupe me 5 vetë. Secilit anëtar të grupit i caktohet një rol. Mësuesja jep udhëzimet për sigurinë e punës.</p>			
<p>Përvijim i të menduarit: Nxënësit veprojnë në grupe sipas metodës së parashtruar në libër. Duhet të tregohen të kujdesshëm me tallashin e hekurit, duke e tundur me kujdes në një enë, dhe kur kyçin rrymën. Mësuesi/ja monitoron punën dhe vazhdimisht u kujton nxënësve të jenë të kujdesshëm. Pasi kanë regjistruar të gjitha rezultatet për secilën fazë të eksperimentit punojnë në grup për të shqyrtuar rezultatet.</p>			
<p>Rishikim në grup: Më pas referojnë me radhë kryetarët e grupeve. Ata pyeten se cilat ishin problemet kryesore që hasën gjatë punës dhe çfarë mund të përmirësojnë në të ardhmen në mënyrën e të vepruarit në eksperimente.</p>			
<p>Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për parashikimin se çfarë do të ndodhë me modelin e fushës magnetike nëse rritet rryma në përçues, për punën në grup për kryerjen e matjeve, për nxjerrjen e përfundimeve, si edhe për zbatimin e rregullës së dorës së djathtë për fushën elektromagnetike.</p>			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 15. Detyra. Magnetizmi dhe elektromagnetet <i>elektricitetin dhe magnetizimin.</i>			
Rezultatet e të nxënit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore: 1. Të gjejnë fjalët e sakta në tabelë. 2. Të vizatojnë drejtimin e gjilpërës magnetike. 3. Të identifikojnë faktorët që janë të rëndësishëm në një situatë të dhënë.		Fjalët kyç: gjilpërë magnetike, magnetizim, elektromagnet.	
Mjetet: Fletë Pune 3.4 dhe 3.5	Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë e nxënësve nga lënda e Matematikës dhe e Letërsisë.		
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Diskutim për njohuritë paraprake: Diskutimi zhvillohet kryesisht në lidhje me vetitë e magneleve, ndërtimin e elektromagnetit, të bërtamës së hekurit e të fushës magnetike etj.			
Punë e pavarur: Pasi mësuesi/ja bindet se njohuritë janë përveçuar nga të gjithë nxënësit, u shpërndan atyre Fletën e Punës 3.4. I udhëzon ata të shpjegojnë kuptimin e fjalëve të gjetura.			
Rishikim në dyshe: Nxënësit punojnë në dyshe Fletën e Punës 3.5, duke ndjekur shembullin e dhënë.			
Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për gjetjen e fjalëve të sakta në tabelë, për vizatimin e drejtimin të gjilpërës magnetike dhe për identifikimin e faktorëve që janë të rëndësishëm në një situatë të dhënë.			
Detyrë shtëpie e sugjeruar: Kërkoni informacione për trenat elektrike të shpejtësisë së lartë, duke u bazuar në fletën e punës 3.6.			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
<p>Tema mësimore 16. Përsëritje. Elektriciteti dhe magnetizmi (Orë për vlerësim)</p>			
<p>Rezultatet e të nxënësve të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:</p>		<p>Fjalët kyç: bërthamë e elektromagnetit, zile elektrike.</p>	
<p>1. Të njohin ndërtimin dhe funksionin e elektromagnetit.</p>			
<p>2. Të tregojnë si punon një zile elektrike dhe rregullën e dorës së djathtë.</p>			
<p>3. Të argumentojnë përgjigjet e tyre.</p>			
<p>Mjetet: Tabela mësimore</p>		<p>Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo temë lidhet me njohuritë e nxënësve në lëndën e Matematikës.</p>	
<p>Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve</p>			
<p>Diskutim për njohuritë paraprake: Mësuesi/ja fton nxënësit të krijojnë një ese duke përdorur fjalët: <i>elektromagnet, sistem rele, çelës magnetik, magnet, pole të një magneti, gjilpërë e busullës.</i></p>			
<p>Punë individuale: Nxënësit, të ndarë në dy grupe, punojnë individualisht ushtrimet: grupi A) 1, 3, 5 dhe grupi B) 2, 4, 6. Në fund të orës mësuesi/ja mbledh fletët dhe bën korigjimet. Detyrat vendosen në dosjen e secilit nxënësi.</p>			
<p>Vlerësimi: Në përfundim të mësimit nxënësit vlerësohen për ndërtimin dhe funksionin e elektromagnetit, për demonstrimin si punon një zile elektrik, për formulimin e rregullës së dorës së djathtë dhe për argumentimin e përgjigjeve të tyre.</p>			
<p>Detyrë shtëpie e sugjeruar: Në shtëpi nxënësit mund të punojnë ushtrimin 7 dhe ushtrime plotësuese nga Fleta e Punës faqe 71. Mund të punojnë në grupe dyshe për të sjellë informacione nga jeta e fizikanit Danaz Ersted, i cili në vitin 1820 provoi për herë të parë lidhjen midis dukurive elektrike dhe atyre magnetike.</p>			

PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE nr. 17

Data _____

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 17. Test i tremujorit të tretë (Prill-Qershor)			
Rezultatet e të nxënimit të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
<ol style="list-style-type: none"> 1. Të tregojnë se një përçues me rrymë krijon rreth tij fushë magnetike. 2. Të listojnë faktorët që ndikojnë në fuqinë e elektromagneeteve. 3. Të shpjegojnë çfarë ndodh kur magnetizohet një shufër prej hekuri. 			
Mjetet: Testet përgatiten në fletë formati A4.			
Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Ky test formulohet në bazë të njohurive të fituara nga nxënësit gjatë tremujorit të tretë në lëndën e Fizikës.			
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Një model testi ndodhet në rubrikën “Shtojcë”. Aty përfshihen njohuri mbi kapitujt “Drita dhe tingulli” dhe “Elektriciteti dhe magnetizmi”. Koha e zhvillimit të testit: 45 minuta.			

Fusha: Shkencat e natyrës	Lënda: Fizikë	Shkalla: IV	Klasa: VIII
Tema mësimore 18. Vlerësim i portofolit të nxënësit			
Rezultatet e të nxënës të kompetencave të fushës sipas temës mësimore:			
1. Të përshkruajnë shkurtimisht përmbajtjen e portofolit.			
2. Të evidentojnë punimet më të realizuara.			
3. Të vlerësojnë rëndësinë e plotësimit të portofolit.			
Mjetet: detyrat e punuara në klasë, në shtëpi, projekti dhe materiale të tjera.		Lidhja me fushat e tjera ose me temat ndërkurrikulare: Kjo orë mësimi lidhet me njohuritë e nxënësve me Artin Pamor, TIK, si dhe me gjuhën dhe komunikimin.	
Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve			
Secili nxënës vrojton portofolin e nxënësit pranë. Ata mbajnë shënime për punimet më të mira dhe ato që duhen përmirësuar, duke përdorur një shkallë vlerësimi nga 1-3. Shohin dhe vlerësojnë rregullsinë e dosjes, organizimin e punimeve, punimet individuale, detyrat e shtëpisë e të klasës, testet, si edhe vlerësimet e mësueses. Nxënësit, të cilët kanë mangësi të detyrave ose detyra për të përmirësuar, mund t'i plotësojnë ato në shtëpi.			
Në fund mësuesi/ja bën vlerësimin e të portofolave më të mirë të klasës dhe të portofolave të tjerë.			
Diskutohet me nxënësit rreth detyrave që i kanë realizuar me më shumë dëshirë dhe çfarë do të donin të përmirësonin.			

IV. SHTOJCA

Kompetencat kyç lidhen me *kompetencat e fushës* nëpërmjet *rezultateve të të nxënit* të secilës prej tyre. Lidhja mes rezultateve të të nxënit të kompetencave të fushës dhe të kompetencave kyç siguron zhvillimin e ndërsjellë të tyre dhe mundëson integrimin lëndor.

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE KYÇ

Kompetencat kyç

I. Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit

Nxënësi:

1. shpreh mendimin e vet për një temë të caktuar me gojë ose me shkrim, si dhe në formë të tjera të komunikimit;
2. dëgjon me vëmendje paraqitjen dhe komentet e bëra nga të tjerët rreth një teme, duke bërë pyetje, komente, sqarime dhe propozime;
3. shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin e përshtatshëm;
4. veçon informacionin kryesor nga një libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e përdor atë si referencë gjatë hartimit të një punimi ose të një detyre me shkrim;
5. shpreh drejt një mendim apo një kërkesë, me gojë ose me shkrim, në gjuhën amtare ose të huaj, për një situatë të caktuar (për udhëzim, ndihmë, informim, orientim etj.), duke ndërvepruar në grup ose në klasë;
6. përdor programet kompjuterike për komunikim të drejtpërdrejtë dhe në distancë nëpërmjet formave të caktuara të komunikimit (për nevojat e veta apo si detyrë shkollore).

II. Kompetenca e të menduarit

Nxënësi:

1. parashtron argumente pro ose kundër për një temë/problem të caktuar gjatë një debati ose publikimi në media;
2. harton planin e punës për realizimin e një krijimi/detyre (letrar, shkencor, artistik), duke përcaktuar hapat kryesore të zbatimit;
3. zgjidh një problem (matematikor, gjuhësor, shoqëror, shkencor etj.) dhe arsyeton përzgjedhjen e procedurave përkatëse;
4. përzgjedh dhe demonstroi strategji të ndryshme për zgjidhjen e një problemi (matematikor, gjuhësor, shkencor, artistik, shoqëror) duke paraqitur rezultat të njëjtë;
5. interpreton mënyra të zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë;
6. krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces a dukuri shoqërore, natyrore ose artistike;
7. përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

III. Kompetenca e të nxënit

Nxënësi:

1. përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (libra, revista, udhëzues, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën;
2. shfrytëzon të dhënat për të demonstruar të kuptuarit e koncepteve numerike, grafike, simboleve, formulave në shkencë natyrore dhe shoqërore, matematikë ose arte, duke i sqaruar nëpërmjet formave të ndryshme të të shprehurit;
3. zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna nga një burim (tekst shkollor, libër, internet, medie) për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet;
4. shfrytëzon portofolin personal për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit, të përparimit dhe të përmirësimit të suksesit në fushën e caktuar;
5. ndërlihdh temën e re ose një çështje të dhënë me njohuritë dhe përvojat paraprake,

duke i paraqitur në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafike) sipas një radhitjeje logjike;

6. përdor programe të përshtatshme kompjuterike për zgjidhjen e problemave dhe kryerjen e detyrave në fusha të ndryshme të dijes;

7. parashtron pyetje (*pse?*, *çfarë?*, *si?*, *kur?*), i organizon mendimet e veta në formë të shkruar për temën/problemin e dhënë dhe vlerëson përparimin e vet deri në zgjidhjen e duhur;

8. menaxhon emocionet, ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve dhe të mjeteve gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti (në klasë/shkollë apo gjetiu).

IV. Kompetenca për jetën, sipërmarrjen dhe mjedisin

Nxënësi:

1. zhvillon një projekt individual ose në grup për kryerjen e një aktiviteti mjedisor apo shoqëror me rëndësi për shkollën ose për komunitetin;

2. diskuton në grup për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, pasojat që sjell dëmtimi i tij për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhen ndërmarrë për evitimin e tyre;

3. identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën, etj) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet;

4. përdor programet kompjuterike për përgatitjen e materialeve të nevojshme grafike, ilustrime, dizenjime (të ftesave, të pamfleteve, të njoftimeve apo të publikimeve);

5. bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj);

6. merr pjesë si anëtar i një jurie (në nivel klase apo shkolle) për vlerësimin e një aktiviteti/konkursi sportiv, shkencor, artistik etj., duke u bazuar në kriteret e paracaktuara.

V. Kompetenca personale

Nxënësi:

1. prezanton para nxënësve procesin e përgatitjes së një ushqimi ose të specialiteti shtëpiak sipas një recete për ushqyerje të shëndetshëm;

2. vlerëson përmbajtjen e vlerës ushqimore (ndikimin pozitiv dhe negativ në shëndet) për tri lloje ushqimesh, të cilat konsumohen në mjedisin e tij ose përreth;

3. diskuton në grup me argumente për rëndësinë që ka respektimi i regjimit ditor dhe i aktiviteteve fizike për shëndetin dhe për jetën e njeriut;
4. identifikon shenjat/simbolet e rrezikut në prodhime apo objekte konkrete;
5. kërkon ndihmë/këshillë nga personat dhe shërbimet përkatëse për përkrahje ose mbështetje në situata të ndryshme të dyshuara/supozuara si potencialisht të rrezikshme, në të cilat cenohet shëndeti fizik dhe mendor;
6. përshkruan ndryshimet fizike, psikike dhe emocionale të fazës së pubertetit, duke paraqitur fakte për ndikimin e tyre në mënyrën (stilin) e jetesës;
7. shpjegon gjatë një debati ose prezantimi (me gojë ose me shkrim) pasojat e përdorimit të duhanit, të alkoolit, të drogës dhe të substancave të tjera të dëmshme për shëndetin dhe mirëqenien e individit;
8. merr pjesë ose drejton punën në grup, bashkëpunon me përfaqësues të komunitetit për të ndihmuar moshatarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit që kanë probleme shëndetësore, sociale, ekonomike etj., si dhe raporton (me gojë / me shkrim) për përvojat personale të fituara.

VI. Kompetenca qytetare

Nxënësi:

1. zbaton dhe respekton rregullat e mirësjelljes në klasë, shkollë etj., si dhe mban qëndrim aktiv ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë ato, duke shpjeguar pasojat për veten dhe për grupin ku bën pjesë;
2. reagon ndaj sjelljeve të pahijshme në shkollë/klasë dhe jashtë saj, të cilat ndikojnë në raportet ndërpersonale, analizon shkaqet e manifestimit të tyre dhe propozon mjete për përmirësimin e tyre;
3. tregon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerren pa dëmtuar interesat e të tjerëve, veprime, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror/ komunitetit;
4. merr pjesë në aktivitetet që promovojnë tolerancë dhe diversitet kulturor, etnik, fetar, gjinor etj, në shkollë apo në komunitet, ku përfshihen moshatarë të të gjitha përkatësive të përmendura, që jetojnë në bashkësinë e gjerë.

VII. Kompetenca digjitale

Nxënësi:

1. përdor mediet digjitale dhe mjediset informative për të komunikuar dhe bashkëpunuar, duke përfshirë komunikimet në distancë *për zhvillimin e njohurive*;
2. analizon, vlerëson, menaxhon informacionin e marrë elektronikisht (p.sh., hedhin disa informacione të marra nga interneti duke i përmbledhur në një tabelë ose grafik);
3. përcakton mjetet e duhura teknologjike për qasjen në informacione dhe burime elektronike;
4. zhvillon aftësinë mediatike **për identifikimin e burimit të informacionit dhe këndvështrimin analitik për gjykimin e tyre** (p.sh., dallon nëse një material i marrë nga interneti është fakt dhe burimi është parësor ose dytësor);
5. ndërton sisteme të teknologjisë së informacionit nëpërmjet mbledhjes, përpunimit dhe daljes së informacionit, si dhe të reagimeve të mësuesve/eve ose nxënësve/eve e tjerë;
6. debaton mbi ndikimin, përparësitë dhe jopërparësitë e teknologjive ekzistuese dhe të reja në jetën e individit, shoqërisë apo komunitetit.

REZULTATET E TË NXËNIT SIPAS KOMPETENCAVE TË FUSHËS

Kompetencat e fushës

Kompetencat e fushës së shkencave natyrore mund të konsiderohen si komponentë të kompetencës së kërkimit shkencor. Ato janë renditur më poshtë.

Kompetenca I. Identifikimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre

a) Nxënësi përcakton problemin:

- identifikon karakteristikat shkencore të problemit;
- thekson elementet që kanë lidhje me njëra-tjetrën;
- formulon problemin.

b) *Nxënësi zgjedh hetimin ose skicon strategjinë:*

- merr në shqyrtim strategji të ndryshme;
- merr parasysh kufizimet që shoqërojnë secilin skenar;
- zgjedh atë që ai mendon se është strategjia më e mirë;
- argumenton zgjedhjet e bëra;
- planifikon procedurën.

c) *Nxënësi analizon rezultatet e tij/saj ose zgjidhjen:*

- kërkon trendet domethënëse në të dhënat ose provat tipike;
- kontrollon rezultatet sipas procedurës;
- formulon probleme të reja ose sugjeron mënyrat e përmirësimit të zgjidhjes;
- nxjerr rezultatet.

ç) *Nxënësi realizon procedurën:*

- ndjek hapat e planit;
- nëse është e nevojshme, përshtat testet e tij, rishikon planin e tij ose kërkon një mënyrë të re për zgjidhjen e problemit;
- mban shënim për çdo detaj ose vrojtim të nevojshëm për analizën e problemit.

Kompetenca 2. Përdorimi i mjeteve, i objekteve dhe i procedurave shkencore

a) *Nxënësi identifikon ndikimet e shkencës dhe të teknologjisë:*

- studion ndikimet afatgjata të shkencës dhe të teknologjisë tek individët, shoqëria, mjedisi dhe ekonomia;
- vendos shkencën dhe teknologjinë në kontekstet e tyre sociale dhe historike, si dhe studion ndikimin e tyre në mënyrën e jetesës së njerëzve;
- identifikon pyetje ose çështje etike.

b) *Nxënësi kupton si funksionojnë objektet teknike:*

- tregon kureshtje rreth disa objekteve teknike;
- shqyrtton përbërjen dhe funksionimin e tyre;
- i zbërthen në pjesë, nëse është e nevojshme;

- identifikon materialet, pjesët dhe tipat e ndryshëm të lidhjeve në objektet teknike;
- dallon sisteme dhe nënsisteme të ndryshme;
- shpjegon si funksionojnë ato.

c) *Nxënësi kupton dukuritë natyrore:*

- pyet veten rreth mjedisit të tij/saj;
- shqyrton dukuri të veçanta;
- përshkruan karakteristikat e tyre;
- i ilustron ato me diagrame skematike;
- shpjegon dukuritë duke përdorur ligjet ose modelet;
- siguron koherencën e shpjegimit;
- familjarizohet me konceptet që lidhen me dukuritë dhe pranon lidhjen e tyre.

Kompetenca III. Komunikimi në gjuhën dhe terminologjinë e shkencës

a) *Nxënësi shkëmben informacione shkencore me të tjerët:*

- kupton rolin e ndarjes së informacionit;
- është i hapur në këndvështrimet e të tjerëve;
- krahason të dhënat dhe procedurat e tij/saj me ato të të tjerëve;
- vlerëson këndvështrimin e tij ose zgjidhjen duke i krahasuar ato me të tjerët.

b) *Nxënësi përhap dhe zhvillon njohuritë ose rezultatet shkencore:*

- merr parasysh përbërjen e audiencës;
- përdor mënyra të ndryshme për prezantimin e informacionit (p.sh., simbolet, tabelat, vizatimet teknike);
- përshtat mesazhin sipas tipit të medias që përdor (p.sh. prezantim me gojë ose me shkrim etj.).

c) Nxënësi interpreton dhe formulon mesazhe shkencore:

- përdor informacionin shkencor dhe teknologjik të marrë nga burime të ndryshme;
- sigurohet që burimet të jenë të besueshme;
- vlerëson përshtatshmërinë e tyre;
- prezanton informacionin sipas rregullave dhe konvencioneve të shkencës, teknologjisë dhe matematikës.

Kompetencat zhvillohen përmes **tematikave të përbashkëta të fushës** dhe në program zbërthehen në njohuri/aftësi, shkathtësi/procedura, qëndrime/vlera. Tematikat e përbashkëta të fushës janë elemente të rëndësishme të programit të fushës së shkencave natyrore, sipas të cilave strukturohet përmbajtja lëndore dhe integrimi konceptual i secilës lëndë brenda fushës, në funksion të zhvillimit të kompetencave. Tematika të përbashkëta për shkallën e tretë dhe të katërt janë: *diversiteti, ciklet, modelet, sistemet, energjia, ndërveprimet, shkallëzimi dhe matjet*.

Strukturimi i programit mbi rezultatet e të nxënit për kompetenca në secilën lëndë dhe në tematika të përbashkëta, të njëjta për të gjitha lëndët e fushës, ndihmon në planifikimin dhe zhvillimin e situatave të të nxënit dhe lehtëson vlerësimin e nxënësit për kompetencat kyç.

Situatat e të nxënit janë situata që lidhen me kontekstin e të nxënit. Ato mund të jenë situata në mjedise të mbyllura ose të hapura të nxëni, brenda shkollës ose jashtë saj. Roli i mësuesit në mësimdhënien përmes situatave është ai i udhëheqësit dhe i lehtësuesit gjatë nxënies aktive të nxënësit.

Realizimi i **temave ndërkurrikulare** dhe i **lidhjes ndërlëndore** nëpërmjet lëndëve të shkencave natyrore janë, gjithashtu, elemente të rëndësishme të programit.

Metodat, teknikat, strategjitë e të nxënit në fushën e shkencave natyrore janë faktorë të rëndësishëm për një nxënie të suksesshme që nxit interesin, gjithëpërfshirjen, ndërveprimin dhe punën kërkimore të nxënësit. Përzgjedhja dhe përdorimi i tyre nga mësuesit bëhet në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësit, duke respektuar stilet e ndryshme të të nxënit.

